

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7722 E hënë 27 Nëntor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Opinion** **Ditës**  
Në disa shkrime mbi emërimin e ish-gjeneralit Sandër Lleshaj si ministër i Brendshëm, veç të tjerash, vërehet një konceptim i cekët për gjeneralët ...  
Vijon në faqen 20

Nga JORGJI KOTE  
**Për gjeneralët të paqes dhe ministrin Lleshaj**  


**Opinion** **Ditës**  
Çmimi i naftës është rritur në Francë dhe ka shkuar në 1.51 euro për litër (140 lekë të vjetra më shumë se tek ne). Pritet të rritet edhe me 3.9 cent ...  
Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI  
**Ari i zi në Francë dhe në Shqipëri**  




Kryeministri për diplomatin: What the fuck!

## Rama-Haradinaj, dy qeveritë bashkë në Pejë. "I djeg" Vuçiçit: Hipokrizi

Edi Rama: Kush e quan Hashim Thaçin tradhtar, është gomar. Miratohen vendimet e përbashkëta

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka ashpërsuar gjuhën ndaj Bashkimit Europian për sjelljen e tij ndaj shqiptarëve, ndërsa e ka konsideruar të drejtë taksën e Kosovës ndaj mallrave serbe, duke e quajtur atë si një përgjigje politike ndaj veprimeve të Serbisë. Ai i bëri këto komente gjatë mbledhjes së përbashkët ...

Në faqen 5

## MINISTRIA E FINANCAVE PUBLIKON LISTEN E RE TE ATYRE QE MARRIN PARATE

# ISH-TE PERNDJEKURIT, 1400 EMRAT QE DO TE KOMPENSOHEN

Dëmshpërblimi i trashëgimtarëve, dokumentet që mungojnë në dosjen e secilit aplikant. Brenda shkurtit 2019 duhet t'i dorëzojnë për të përfituar nga fondi



(Në foto) Ish-të përndjekur në protestë

Në faqen 12-15

**KOSTO E LARTE**  
**Basha: Unaza e Re, vjedhje 40 milionë euro për vetëm 2 km, aferë korruptive**

Në faqen 4

**NGJARJA E 4 TETORIT**  
**Vrasja në Bllok, dëshmia e komandos: Dola nga lokali sapo nisi sherri**

Në faqen 7

**BUXHETI 2019**  
**Biznesi në komision: Të ulet taksat e ndërtimit dhe çmimi i ujit dhe energjisë**

Në faqen 6

**MONUMENTI**  
**Kisha e shekullit XII, trashëgimia shqiptare në kalanë e Tivarit**

Në faqen 19

**PROTESTA**  
**Banorët e Unazës së Re përzënë ARRSH. I riu në gjyq: Më thyen gishtat pas arrestimit**  
Në faqen 2-3

Gazetarja Rezarta Delisula publikon albumin historik në përvjetorin e ngritjes së flamurit

## "Tirana-Mahnia" ju rrëfen 'sekretet' e kryeqytetit

Mania dhe mahnitja për qytetin-simbol, në sytë e një "tironaseje të vjetër"

Ja një portë përballë "Shkollës së Kuqe". Eshhtë druri, ka çekiçin në formë dore, që shërben si zile, tri rreshta tjegulle kafeje mbi, ka avllitë të bardhë në dy anët e saj. Ishte identik me portën e shtëpisë sime, nga e cila kemi ruajtur si relike vetëm çekiçin. Zhvillimi urban, evropiani-



zimi, plani francez i qendrës, lëvizja e lirë, poliçendrat, projekti danez apo austriak... janë konceptet që po vrasin kujtimet e mia. Sa pak që ka mbetur nga qyteti im". Kur Rezi Delisula shkruante këto radhë më shumë se një vit më parë, ende nuk e kish ...

Në faqen 17

## UNAZA E MADHE PROTESTA

Gjykata lë në burg pa afat 18-vjeçarin. Avokati: Prokuroria nuk ka prova

# "Rebelohet" në gjyq Daniel Dobraj: Policia më goditi me grushte e shqelma

*"Më shkelën me këmbë dhe më thyen dy gishtat e dorës së djathtë, që e kam të fashuar"*

TIRANË

Daniel Dobraj, i cili akuzohet për plagosjen me kapsollë të policës Ina Nuka gjatë protestës që zhvillouan banorët e zonës së "Astirit" para Kuvendit ka dalë dje në gjyq për masën e sigurisë. Gjatë seancës gjyqësore, Prokuroria ka kërkuar "Arrest me burg" ndaj tij. Seanca u zhvillua në Gjykatën e Tiranës, ku 18-vjeçari nga kafazi i xhamit ka treguar dorën e djathtë të fashuar. Daniel Dobraj ka deklaruar se është dhunuar dhe se policia i ka thyer gishtat si hakmarrje për gjykimin e efektivës së forcave "Shqiponja" në dorë. Të pranishëm në seancë ishin edhe deputetë të PD-së dhe të LSI-së, ndërkohë që gjykatësi Besnik Hoxha kërkoi zhvillimin e masës së sigurisë pa praninë e medias. Pas paraqitjes së provave materiale nga prokurorët e çështjes, Kreshnik Ajazi dhe Ndini Tavani, trupi gjyqësor i kryesuar nga Besnik Hoxha ka vendosur masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj 18-vjeçarit për akuzat "Plagosje të rëndë me dashje", "Mbajtje të lëndëve shpërthyes", "Kundërshtim të forcave të policisë", "Organizim dhe pjesëmarrje në grumbullime dhe manifestime të paligjshme" si dhe "Prishje të qetësisë publike". GJYQI

Para se të niste seanca (në pritje të trupit gjyqësor), Daniel Dobraj ka shpërthyer me akuzat ndaj policisë. Ai është shprehur se është dhunuar barbarisht dhe se dy gishtat e dorës së djathtë (e kishte të fashuar) nuk i lëviz dot. "Policia më ka goditur me grushte e shkelma. Më ka shtypur me këmbë gishtat e dorës së djathtë në shenjë hakmarrjeje për policen, të cilën nuk isha unë që e gjuajta me kapsollë", është shprehur 18-vjeçari, i cili u arrestua nga policia mbrëmjen e të premtes (më 23 nëntor), një ditë pas protestës që u zhvillua para parlamentit. Ai ka qenë në një linjë me dëshminë e dhënë para bluve pas vënies në pranga. Dobraj ka mohuar kategorikisht se ka qenë ai që hodhi kap-



Daniel Dobraj në sallën e gjyqit

sollën që plagosi rëndë efektivën e forcave "Shqiponja", Ina Nuka. Pavarësisht mohimit të akuzës, togat e zeza

kanë pranuar kërkesën e organit të akuzës për lënim në qeli të Dobrajt. Ndërkaq, avokati mbrojtës Alfred

Duka ka hedhur poshtë akuzat ndaj klientit të tij. Ai është shprehur se prokuroria nuk ka prova dhe se 18-

### AKUZAT NDAJ POLICISË

Para se të niste seanca (në pritje të trupit gjyqësor), Daniel Dobraj ka shpërthyer me akuzat ndaj policisë. Ai është shprehur se është dhunuar barbarisht dhe se dy gishtat e dorës së djathtë (e kishte të fashuar) nuk i lëviz dot.

"Policia më ka goditur me grushte e shkelma. Më ka shtypur me këmbë gishtat e dorës së djathtë në shenjë hakmarrjeje për policen, të cilën nuk isha unë që e gjuajta me kapsollë", është shprehur 18-vjeçari, i cili u arrestua nga policia mbrëmjen e të premtes (më 23 nëntor).



Protesta e banorëve te zona e Unazës së Re

### DËSHMIA E DANIEL DOBRAJ

Pas arrestimit, Daniel Dobraj ka deklaruar para bluve se kishte marrë pjesë në protestë, ndërsa pohoi se nuk kishte përdorur sende të kundraligjshme. Mësohet se, "Theksoj se kam pasur vetëm tre kapsolla, të cilat i kam ndezur dhe i kam hedhur në drejtim të llamarinave që rrethojnë namazjan që po ndërtohet. Ka pasur një moment që disa punonjës të policisë kanë dashur të më ndalonin në protestën e mësipërme dhe unë nuk kam pranuar të më fusnin në makinë, duke e konsideruar veprimin e tyre të padrejtë. Ndërkohë mes nesh kanë ndërhyrë disa persona të tjerë dhe vetëm e kam gjendur veten në turmë dhe kam ikur me vrap. Rreth orës 19:30 të datës 23.11.2018 ka ardhur babai im, shtetasi Viktor Dobraj dhe pasi ka biseduar me avokatin, jemi nisur për t'u dorëzuar në Komisarariat dhe Policisë nr.3, sa jam larguar nga banesa që unë kisha qëndruar, kanë ardhur forcat e policisë, më kanë vënë pistoletën në kokë duke m'u prezantuar si punonjës policie, pasi më kanë futur në makinë kanë ushtruar dhunë ndaj meje në të gjitha format dhe duke më sharë gjatë gjithë rrugës deri kur kemi përfunduar në Drejtorinë e Policisë Tiranë. Në ambientet e Drejtorisë Tiranë sjelljet kanë qenë korrekte dhe nuk është ushtruar asnjë dhunë", thuhet në dëshminë e tij në polici.

## U nxorën jashtë sallës së gjyqit, Noka: Veprim cubash për të fshehur barbarinë e bandës së Ramës



fytyra e vërtetë e qeverisë kriminale "Rama". Danjeli që protestonte për banesën dhunohet barbarisht në furgonin e policisë së shtetit. Askush të mos ia falë Edi Ramës dhimbjen e këtij djali dhe të gjithë familjeve të Unazës së Re!", shkruan Mehmetaj. Ndërkaq, deputeti demokrat, Flamur Noka ka folur jashtë gjykatës pasi nuk u lejuan të marrin pjesë

në seancën për caktimin e masës së sigurisë për 18-vjeçarin. Ai e quajti veprim cubash të shtetit që po jep shpirt. "Ky nuk është veprim i ligjit dhe shtetit ligjor. Është veprim cubash të veshur me kapele dhe çizme polici. Veprimi i cubave të shtetit që po jep shpirt. E gjitha për të fshehur dhunën dhe barbarinë që banda e Edi Ramës, e veshur me uniformë ka ush-

truar ndaj këtij djaloshi. Prandaj u bë me dyer të mbyllura. Prokurori Edi Rama së bashku me gjyqtarin Edi Rama nuk mund ta fshehin. Kjo është fytyra e këtij shteti", deklaroi Noka. I pyetur nëse do vazhdojnë të mbështesin qytetarët e Unazës së Re, Noka tha se s'do e lejojnë kryeministrin që të nxjerrë banorët nga shtëpitë. "Opozita është e unifikuar për të mbështetur deri në fund banorët e Unazës, janë qytetarë të Tiranës dhe meritojnë gjithë respektin dhe të kenë shtëpinë e tyre. Ata që kërkojnë t'i nxjerrin si qen qytetarët, ne do t'i ndalojmë. Ne jemi që çdokush të kompensohet deri në një. Mundi i tyre nuk mund të shkellet me këmbë as nga Edi Rama e as nga dyliberët rreth tij", tha deputeti i PD-së.



U la në burg, qytetarët e Unazës së Re: "O Daniel, o hero, gjithë Unaza ty të do"

# Nis shembja e shtëpive, banorët e "Astirit" përzënë inxhinierët e ARRSH

Peticion Metës dhe Markut: Të ndërpriten punimet

Valentina Madani

Grupet e punës së ARRSH, Bashkisë Tiranë dhe ALUIZNI-t zbkruan dje në terren për të bërë matjet dhe vlerësimet e objekteve që preken nga projekti i Unazës së Madhe. Por, vetëm pasi kryen disa matje, inxhinierët e ARRSH u detyruan të largohen për shkak të banorëve që i kundërshtuan. Ata u penguan nga banorët të zonës, të cilët i dëbuan dhe nuk i lejuan të bëjnë punën. Inxhinierët u rikthyen sërish më pas, por vetëm me prezencën e policisë, duke bërë vlerësimin e 17 objekteve me dokumente pronësie. "Gjatë punës në terren banorët të tjerë të zonës, që nuk kanë lidhje me objektet të cilat po verifikohen, kanë penguar me dhunë inxhinierët në ushtrimin e detyrës. Ata kanë dhunuar edhe mjediset private të banorëve me dokumentacion pronësie, të cilët kanë qenë të pranishëm dhe të gatshëm për verifikimin e banesës në funksion të shpronësimit. Ky grup banorësh lëviz në segmente të ndryshme të Unazës duke penguar inxhinierët në kryerjen e detyrës, pavarësisht se nuk kanë lidhje me objektet të cilat po verifikon ARRSH", - njoftoi ARRSH. Më pas banorët e tjerë të zonës, që nuk ishin pjesë e banesave që po verifikoheshin, penguan edhe punonjësit e bashkisë për të hequr pemët dhe shtyllat elektrike në segmentin nga pallati me shigjeta drejt sheshit "Shqiponja". Vlerësimi i objekteve i hap rrugë nisjes së shpronësimeve. Edhe në ditët në vijim, punonjësit e ARRSH do të jenë në terren për të bërë vlerësimet. Ndërkohë, mësohet se në terren ka nisur edhe prishja e banesave të para. Raportohet se janë prishur dy banesat e para, për t'i hapur kështu rrugë prishjes së ndërtesave të tjera dhe fillimit të punimeve për ndërtimin e Unazës së Madhe.

**PETICIONI**  
Banorët që preken nga projekti i Unazës së Madhe i kanë dërguar një peticion kryeprokurores Arta Markut dhe Presidentit Ilir Meta. Ata shprehin shqetësimin dhe kërkojnë ndërprerjen e punimeve. Po ashtu, mësohet se banorët në peticionin e tyre kanë kërkuar lirin e dy të arrestuar që



Inxhinierët e ARRSH, dje në zonën e "Astirit"

**VERIFIKIMI**

Vetëm pasi kryen disa matje, inxhinierët e ARRSH u detyruan të largohen për shkak të banorëve që i kundërshtuan. Ata u penguan nga banorët të zonës, të cilët i dëbuan dhe nuk i lejuan të bëjnë punën. Inxhinierët u rikthyen sërish më pas, por vetëm me prezencën e policisë, duke bërë vlerësimin e 17 objekteve me dokumente pronësie.

**"Pas 'Astirit', katastrofa do shfaqet në Vlorë"**

## I riu me dorë të thyer në gjykatë, Berisha: Hakmarrje e Ramës

Pamjet e 18-vjeçarit Daniel Drobaj brenda kafazit të xhamtë në Gjykatën e Tiranës, ku shihet me dorën e thyer dhe të fashuar, solli reagimin e ashpër të ish-kryeministrit Berisha. Sipas tij, ky ishte një akt primitiv hakmarrës që u bë me urdhër të Ramës. "Ja si i thyen studentit të shkëlqyer Daniel Drobaj gishtërinjtë, në një akt primitiv hakmarrjeje, narkos-it me urdhër të Edvin Kristaq. Urretjes për një akuzë të paprovuar dhe fund e krye politike. Sb.", shkruan Berisha. Po dje ish-kryeministri postoi në "Facebook" mesazhin e një qytetari dixhital, i cili shprehet se pas prishjeve të shtëpive në



**Edi Paloka**

"Edvin, ti ose jeton vërtetë në 3D e fantazisë tënde dhe nuk e sheh urretjen me të cilën po të rrethojnë çdo ditë e më shumë shqiptarët, ose je kthyer papritur në trim të cartun e nuk po don me dit... Fund të tmerrshëm do kesh", shkruan Paloka në "Facebook".

"Astiri", fushata e prishjeve do të vijojë edhe në Vlorë. Sipas mesazhit të qytetarit, projekti për ndërtimin e Unazës së Vlorës do të shoqërohet me prishja masive dhe për këtë bën përgjegjës shefin e qever-

isë, Edi Ramën. Mes rreshtave, qytetari i ankohe Berishës, ndërsa nuk hezitoi ta quajë veprimin e radhës, i cili fillon në janar të vitit të ardhshëm si "katastrofë".

gjatë protestës që ndodhi para Kuvendit. Banorët e Unazës së Re protestuan sërish pasditën e djeshme, duke u vendosur në rrugën pranë mbikalimit të pallatit me shigjeta, në shenjë proteste për vendimin që parashikon prishjen e banesave të tyre për ndërtimin e Unazës së Madhe. Protestuesit bënë të qartë se nuk do të lejojnë askënd t'u prishë shtëpitë e tyre dhe se pronën do ta mbrojnë me gjak. "O Daniel, o hero, gjithë Unaza ty të do", ishte një nga thirrjet e përsëritura në kor të protestës, kushtuar 18-vjeçarit Daniel Drobaj, të arrestuar si i dyshuari që

dhodi kapsollën që la të plagosur efektiven e forcave "Shqiponja" të Policisë, Ina Nuka, gjatë protestës së të enjtes para parlamentit. Drobaj dje u la në masën e arrestit me burg nga Gjykata e Tiranës. Në protestë ishin të pranishëm edhe deputetë të opozitës. Deputeti demokrat, Klevis Balliu, i bëri thirrje kryeministrit Edi Rama që të tërhiqet nga vendimi për t'u prishur shtëpitë banorëve. "Është momenti që Rama të tërhiqet nga ky vendim korruptiv. Nëse ai nuk do të tërhiqet, ai do të përballlet me revoltën popullore. Dhuna e ushtruar ndaj

Danielit ka vetëm një përgjegjës dhe ai është Edvin Kristaq Rama", deklaroi Balliu. Kurse, njëri prej të arrestuarve për protestën para parlamentit, që më pas u la nga gjykata nën masën e detyrimit paraqitjes deklaroi: "Kam punuar 20 vite në emigrim për të ndërnuar shtëpinë. Pa kaluar mbi trupin tim, nuk e shemb shtëpinë time. Vetëm Zotit i bie në gjunjë dhe jo një njeriu që ha bukë e pi ujë si puna ime. Është shumë e verifikueshme që s'kam prek asnjë pollic, vetëm kam komunikuar me ata dhe i kam thënë që jam në drejtën time".

## Noka: Rama po fsheh dhunën e ushtruar ndaj Danielit

PD dhe LSI ishin në gjykatë dje në mbështetje të Daniel Drobaj, 18-vjeçarit i cili akuzohet se gjymtoi efektiven e policisë. Pas vendosjes së masës së sigurisë arrest me burg, deputeti Flamur Noka tha se ndaj të riut është ushtruar dhunë. Deputeti i PD-së, Flamur Noka akuzoi se kryeministri po fsheh dhunën e ushtruar ndaj Danielit. "Edi Rama po përpiqet të fsheh dhunën që ka ushtruar ndaj një qytetari. Çizmja e pushtetit të Ramës, çizmja e policit ka thyer dy gishtat. Ky është veprim cubash të veshur me kapele dhe me çizme polici. Ky është veprimi i cubave të pushtetit që po jep shpirt të Edi Ramës", deklaroi z.Noka. Kurse deputeti i LSI-së, Braimllari akuzoi: "Rama urdhëroi që gjyqi të bëhej me dyer të mbyllura. Është tipik gjyq politik që bëhej në kohën e diktaturës. E urdhëroi për një arsye, që opinionin publik të mos njihet me realitetin e ushtrimit të dhunës ndaj Danielit".



## Unaza, Shehaj: Rama transferon 20 milionë euro në llogarinë sekrete

Deputeti i PD, Agron Shehaj denoncoi dje se 20 milionë euro të projektit të Unazës së Re do t'i shkojnë një kompanie të regjistruar në parajsë fiskale në Delaware, përmes një kompanie nga ishujt Seyschelle, e cila nuk ka asnjë aktivitet dhe nuk ka as punonjës. Shehaj shkon më tej në denoncimin e tij, ndërsa thotë se ky është një art i ri i vjedhjes së Edi Ramës. "Rreth 20 milionë euro të projektit të Unazës së Re do t'i shkojnë një kompanie të regjistruar në parajsë fiskale në Delaware, përmes një kompanie nga ishujt Seyschelle, e cila nuk ka asnjë aktivitet dhe nuk ka as punonjës. Arsyeja më bindëse për të shpjeguar se pse Edi Rama nuk tregon se kush janë pronarët e kësaj kompanie fasadë është se pas saj është... ai vetë", shkruan Shehaj.



# UNAZA E MADHE ZGJIDHJA

Nis shpërngulja, Veliatj-protestuesve: Larg nga deputetët me "Range Rover"-a

## "Shtëpitë e ndërnuara pa leje s'do prishen". Basha, Ramës: Mashtrues

"Banorët i garantove edhe nëse Enveri të ngjallet"

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, akuzoi dje kryeministrin Edi Rama si një gënjeshtar që mohon vetveten dhe që ka si qëllim vjedhjen e 40 milionë eurove me projektin tek Unaza e Re. Sipas Bashës, kreu i qeverisë po mohon edhe veten teksa gënjën hapur vetëm për të vjedhur përmes projekti të Unazës së Re. Z. Basha postoi një video në "Facebook", deklaroi në 2013-ën, kur u kërkoi votën banorëve të Unazës së Re. "Shtëpitë e ndërnuara pa leje nuk do të prishen edhe sikur Enver Hoxha të ngjallet", - deklaroi në vitin 2013 Rama. Por sot, thekson shefi i opozitës Basha, "për të siguruar vjedhjen 40 milionë euro, Edi Rama mohon dhe vetveten". Në postimin e tij, Basha sjell me video mohimin që i bëri Rama premtimit të tij elektoral vetëm dy ditë më parë. Prej tri javësh banorët e Unazës së Re protestojnë kundër prishjes së shtëpive të tyre nga një projekt i pakonsultuar dhe pa transparencë, në të cilin do të hidhen 40 milionë euro për 2 km rrugë.

**BANESAT**  
Banesat sociale në Shkozë janë gati për familjet e para, të cilat preken nga gjurma e Unazës së Madhe. Dy janë mundësitë që ofron Bashkia e Tiranës për banorët që preken nga projekti i Unazës së Madhe dhe që nuk kanë asnjë dokument, trajtimi me bonus qiraje për tri vite ose banesa sociale. Për të inspektuar kushtet që ofrojnë këto apartamente, në zonën e Shkozës ishte vetë kryebashkiaku Veliatj, i cili apeloi familjet që të aplikojnë pranë njësive administrative për të përfituar. "Në kohë rekord janë bërë gati apartamentet, janë blerë duke nisur nga frigoriferët, tek televizorët, tek çdo nevojë bazë që ka një familje. Ajo që kam parë është që këto kushte këtu janë në fakt disa herë më të mira se sa shtëpitë që po lënë, shpëtzja pa leje... Fillimisht, kjo rezervohet për të gjitha familjet që kanë aplikuar në Bashkinë e Tiranës dhe nuk kanë



Një nga familjet e Unazës së Re, e strehuar dje në banesat sociale në Shkozë

### DEKLARATA

Z. Basha postoi dje një video në "Facebook", deklaroi në 2013-ën, kur u kërkoi votën banorëve të Unazës së Re. "Shtëpitë e ndërnuara pa leje nuk do të prishen edhe sikur Enver Hoxha të ngjallet", - deklaroi në vitin 2013 Rama.



Kryeministri Edi Rama, dje në Kosovë

### SHPERNGULJA

Banorët e "Astirit" që preken nga ndërtimi i Unazës së Madhe kanë filluar të lirojnë banesat që do të prishen, për t'u shpërngulur në shtëpitë sociale të vëna në dispozicion nga ana e Bashkisë së Tiranës. Dje janë shpërngulur dy familjet e para, ndërsa në ditët në vijim pritet që të shpërngulen edhe familjet tjera.

## Unaza e Re, ZRPP: Preken 424 pasuri, do të ndihmojmë çdo banor

Në një kohë kur banorët e "Astirit" protestojnë në shenjë proteste për shembjen e banesave të tyre, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ka ngritur një grup pune prej 11 juristësh e hartografësh për trajtimin e praktikave dhe kërkesave të tyre për kurimet nga projekti. Ky fakt u bë i ditur nga kryeregjistruesi Valdrin Pjetri në një deklaratë për mediat. Ai sqaroi se është verifikuar gjurma e këtij projekti, e cila prek 4 zona kadastrale dhe 424 pasuri. "Nga projekti preken dy zona rurale: Zona Kadastrale 3866 (Yzberish) dhe Zona Kadastrale 2679 (Mëze) si dhe dy zona qyteti: Zona Kadastrale 8210, që shtrihet nga sheshi "Shqiponja" deri tek lumi Lana dhe Zona Kadastrale 8310. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe që Zyra e Regji-



strimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë është pjesë e grupit të përbashkët të punës ka identifikuar rreth 424 pasuri që prek projekti. Çdo banor i zonës së Unazës së Re, që ka nevojë për shërbime nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, mund të paraqitet në çdo moment në zyrën tonë. Tashmë ne kemi hapur një sportel të

### PETRIT VASILI

"Ndërkohë këtë nuk do doja ta quaja Enveri i Ri, ky është një bastardi i ri i diktaturës, ndodhet atje me fadromë në dorë, për të shkatërruar ato shtëpi dhe për të fituar 40 milionë. Dhe në fund të këtyre, ky farë u ka blatur, ky autoritar i ri, ky hajdut i ri, u ka çuar këta njerëz, që ty vënë kryqin e kuq të radhës", tha z. Vasili.

dedikuar vetëm për banorët e Unazës së Re, të cilët do të marrin shërbim brenda ditës. Grupi i punës i ngritur në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë do të punojë edhe me orare të zgjatura me qëllimin ofrimin e shërbimit për banorët e Unazës së Re, të cilët preken nga projekti", deklaroi ai.

asnjë dokument, ndërkohë që të tjerët do marrin shpronësimin. Ftesa ime është, sipas njësive 6, 7 apo Kasharit, apo 11 aplikoni për banesa sociale", deklaroi z. Veliatj. Kryebashkiaku shqijetoi opozitën që ka dalë në mbështetje të banorëve të "Astirit", kur u kërkoi banorëve që të distan-

cohen dhe të mos përdoren politikisht. "Bashkia e Tiranës është për të rregulluar punët e banorëve, jo punët e partive. Për ata deputetë të parkojnë me "Range Rover" dhe si hobi vijnë dhe protestojnë duke sjellë dhe protestues shtetës, besoj se fundi është i qartë", u shpreh

z. Veliatj. Deri më tani për banesa sociale kanë aplikuar 15 familje sipas Veliatjit dhe këto do të jenë të parat që do të zhvendosen në Shkozë. Mësohet se dje janë shpërngulur dy familjet e para, ndërsa në ditët në vijim pritet që të shpërngulen edhe familjet tjera.



## Vokshi në "EPP Women": Skandal i korrupsionit që kushton 40 mln euro

Deputetja Albana Vokshi përcolli në Forumin e Grave të Partisë Popullore Europiane, të zhvilluar në Ljubjanë, shqetësimin se vendosja e një regjimi autokratik në Tiranë ka thelluar edhe dhunën ndaj grave dhe cenimin flagrant të të drejtave të njeriut. Për ta konkretizuar këtë shqetësim, Vokshi iu referua edhe ngjarjeve të fundit ku dhjetëra gra e të mitur kanë qenë viktimat të dhunës shtetërore dhe asaj policore. "Qindra familje shqiptare po nxirren me dhunë nga shtëpitë dhe bizneset e tyre në shkelje të konventave ndërkombëtare e të drejtave ligjore e kushtetuese për realizimin e një projekti korrupsiv rrugor për interesat direkte të kryeministrit", - tha Vokshi në PPE. Vokshi vuri në dukje se, "Shqipëria po shndërrohet në eksperimentin më të rrezikshëm të autokracisë, ku nuk respektohet Kushtetuta, Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat Themelore. Dhuna kundër grave dhe të miturëve këtu ditë në Tiranë është një skandal i korrupsionit shtetëror; që kushton 40 milionë euro dhe që penalizon qindra familje, duke i hedhur në rrugë, pa i siguruar strehimin e kushte normale jetese, ashtu siç konventat ndërkombëtare detyrojnë qeveritë të veprimë". Vokshi kërkoi që anëtarët e "EPP Women", pjesë e Komisionit Europian, PE, deputetë e politikane të vendeve anëtare, të mbështesin këtë kauzë të drejtë të mbi 2 mijë banorëve të Tiranës.

### Doris Pack

Doris Pack, presidente e "EPP Women" shprehu shqetësimin për ngjarjet në Shqipëri dhe rastet e fundit të dhunës e të shkeljes së të drejtave të grave e të drejtave të njeriut, pjesë e kriterit nr. 5 në procesin e integritimit. Pack, e cila u rizgjedh si presidente e "EPP Women" konfirmoi mbështetjen e Forumit të Grave të PPE në mbrojtje të të drejtave të ligjshme të qytetarëve.



Qeveria e Shqipërisë dhe Kosovës zhvilluan mbledhjen e përbashkët në Pejë

# Rama: Serbia dhe BE, sjellje dyftytyrësie ndaj shqiptarëve

Haradinaj: Asnjë metër i Kosovës nuk merret më

**K**ryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka ashpërsuar gjuhën ndaj Bashkimit Europian për sjelljen e tij ndaj shqiptarëve, ndërsa e ka konsideruar të drejtë taksën e Kosovës ndaj mallrave serbe, duke e quajtur atë si një përgjigje politike ndaj veprimeve të Serbisë. Ai i bëri këto komente gjatë mbledhjes së përbashkët të qeverive të Kosovës dhe Shqipërisë, që u mbajt në Pejë dhe ku u nënshkruan një sërë marrëveshesh të rëndësishme që do ndikojnë te qytetarët shqiptarë andej e këtej kufirit. Sipas kryeministrit Rama, vendimi i Kosovës për të taksuar 100% mallrat serbe është normale në kushtet e sjelljes me dy fytyra që Serbia bën ndaj Kosovës, ku nga njëri krah bisedon për të çuar përpara bashkëpunimin dhe në krahun tjetër lobon që atë të mos e njohin si shtet i pavarur. "Një vendim irracional në kushte normale, por krejt normal në kushte irracionaliteti, si ato që përvojim vijimisht qasja e dyftytyrësisë e Serbisë. Kush e sheh tarifën 100% si vendim ekonomik, gabon. Jo, tarifa 100% është reagim politik. Reagim politik ndaj ekeseve të vazhdueshme të një sjelljeje suprematiste të Serbisë ndaj Kosovës. Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale i qeverisë së Kosovës më tregonte mbrëmë se si në Beograd, deri në 2 të natës, me anë të të dërguarve të Europës i kërkoni të hiqte fjalën Republika e Kosovës nga fjalimi që do mbante të nesërmen në një mbledhje të përbashkët, ku edhe Kosova ishte e pranishme me vullnetin e mirë për të nënshkruar një deklaratë të përbashkët në rrugën e paqimit dhe të bashkëpunimit rajonal. 'What the fuck!', - do thuhej në gjuhën e Parlamentit European".



Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama dhe homologu kosovar Ramush Haradinaj, dje në Pejë

**PER SEBINE**  
Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale i qeverisë së Kosovës më tregonte mbrëmë se si në Beograd, deri në 2 të natës, me anë të të dërguarve të Europës i kërkoni të hiqte fjalën Republika e Kosovës nga fjalimi që do mbante të nesërmen në një mbledhje të përbashkët, ku edhe Kosova ishte e pranishme me vullnetin e mirë për të nënshkruar një deklaratë të përbashkët në rrugën e paqimit dhe të bashkëpunimit rajonal. 'What the fuck!', - do thuhej në gjuhën e Parlamentit European".

**SHKURT**

**Mbledhja Kosovë-Shqipëri, Vuçiç: Kjo është hipokrizi**

Mbledhja mes dy qeverive, asaj të Shqipërisë dhe të Kosovës dje në Pejë ka shqetësuar Beogradin. Drejtuesit shtetërorë të Serbisë kanë reaguar menjëherë jo vetëm ndaj mbledhjes së përbashkët të dy qeverive, por edhe ndaj deklaratave të kryeministrit Rama. Njëpërmjet një statusi në rrjetet sociale, presidenti serb, Aleksandër Vuçiç, e ka cilësuar mbledhjen e dy qeverive si hipokrizi, ndërsa nuk ka kursyer as kritikën ndaj BE-së, që lejon një gjë të tillë. "Është kulmi i hipokrizisë, jo vetëm për shqiptarët që jetojnë në Kosovë dhe Shqipëri, por edhe për të gjithë ata që e lejojnë një gjë të tillë", shprehet ai. Tonet mes Kosovës dhe Serbisë janë acaruar ndjeshëm pas dështimit të Kosovës për t'u bërë pjesë e INTERPOL-it, si dhe vendosjes së tarifës për produktet serbe nga Kosova në masën 100 për qind. Gjithashtu, Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç ka theksuar faktin se ky takim mes të dyja vendeve ka për qëllim heqjen e barrierave tregtare mes tyre.

**KED, Meta letër Ruçit: Vendi, në situatë shqetësuese**

Presidenti Ilir Meta nuk e ka hedhur shortin, pasi nuk e ushtron këtë kompetencë dhe përmes një shkresë drejtuar kryeparlamentarit Gramoz Ruçi, informon se ia ka kaluar Kuvendit kompetencat për përzgjedhjen e anëtarëve të KED. Presidenti e ka informuar Kuvendin se për shkak vakumit ligjor nuk mund të hedhë dot shortin për KED. Pas tërheqjes së Metës, shorti për KED pritet të hidhet më 5 dhjetor nga Kuvendi. Me përzgjedhjen e anëtarëve të KED, do t'i hapet rruga edhe funksionimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila prej gati një viti është jashtë funksionit, për shkak të mungesës së anëtarëve. Në letërën drejtuar Ruçit, kreu i shtetit shpjegon edhe arsyet se pse duhet që shorti të hidhet nga parlamenti. "Presidenti i Republikës vlerëson se i takon Kuvendit të Shqipërisë, si institucion ligjberës në Shqipëri të realizojë procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në frymën e Kushtetutës. Presidenti i Republikës, në cilësinë e kreut të shtetit dhe njëkohësisht kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë garanton dhe i ofron Kuvendit të Shqipërisë, të gjithë mbështetjen e nevojshme me qëllim zgjidhjen e kësaj situatë të krijuar dhe kapërcimin e saj", thuhet ndër të tjera në letërën e Metës. Në letër, kreu i shtetit shpreh shqetësim për mosfunksionimin e Gjykatës Kushtetuese për shkak të mungesës së anëtarëve dhe vonesën në ngritjen e institucioneve të reja nga reforma në drejtësi.

## Hiqet tarifet "roaming" mes Kosovës dhe Shqipërisë, njihen patentat

Gjatë mbledhjes së dëshme, të dyja qeverive në Pejë, përfaqësuesit e dy ekzekutiveve kanë nënshkruar 9 marrëveshje dhe protokolle të përbashkëta, ku më të rëndësishmet janë ato për veprime të përbashkëta të kontrollit doganor, si një hap më tej drejt bashkimit të plotë doganor. Sipas kryeministrit Rama, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje eliminohet kontrolli dyfishtë doganor, pasi të dyja palët do ta kryejnë së bashku. Gjithashtu, një tjetër vendim shumë i rëndësishëm, për qytetarët shqiptarë të Kosovës dhe Shqipërisë është edhe ai për heqjen e tarifave "roaming", çka pritet të lehtësojë komunikimin dhe të ulë kostot e telefonisë celulare. Një tjetër vendim që vjen si një lehtësim të banorët e të dyja vendeve është edhe ai për njohjen reciproke të patentave. Dy qeveritë kanë rënë gjithashtu dakord që bashkëfinancojnë

- MARRËVESHJE E FIRMOSURA NDËRMJET DY QEVERIVE:**
1. Marrëveshje për heqjen e çmimeve të shërbimeve roaming.
  2. Protokoll për kryerjen e veprimeve të përbashkëta të kontrollit doganor në pikën kufitare Morinë-Vermicë.
  3. Marrëveshja për bashkëpunim në fushën e borxhit publik, financimeve të huaja dhe marrëdhënieve me institucionet financiare ndërkombëtare.
  4. Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Agjencisë për Pronësinë Industriale të Kosovës dhe Drejtorisë së Pronësisë Industriale të Shqipërisë.
  5. Protokoll mes Ministrive të Bujqësisë për njohjen dypalëshe dhe unifikimin e modeleve të certifikatave shëndetësore, veterinarë që shoqërojnë kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë shtazore.
  6. Marrëveshje bashkëpunimi në fushën e rinisë.
  7. Themelimi i Dhomës Ekonomike bilaterale Shqipëri - Kosovë.
  8. Marrëveshje për njohjen reciproke të patentave për drejtuesit e mjeteve.
  9. Marrëveshje bashkëpunimi në fushën e shëndetësisë.

një studim analitik për të ardhmen e shqiptarëve, që tingëlloj si një tjetër sinjal me destinacion Brukselin. Dy qe-

hapim negociatat nesër. Kosovës i thotë do liberalizohemi sot, do liberalizohemi nesër dhe ndërkohë ajo që ndodh, është që Serbia vazhdon hapë kapituj dhe po ia del duke përdorur tri fytyra, ndërkohë në kemi një fytyrë. Rama e konsideroi në të mirë të shqiptarëve edhe idenë e Presidentit Thaçi për korrigjimin e kufijve, ndonëse kryeministri Haradinaj vazh-

don të mbajë të njëjtën linjë kundërshtie. "Hashim Thaçi është President i Kosovës dhe komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kush ngre dorën ndaj Hashim Thaçit duke e quajtur tradhtar është një gomar, këtë di të them unë. Kjo çështje duhet trajtuar me një vizion të qartë strategjik dhe na takon të gjithëve të ulemi e të shohim të ardhmen", u

shpreh Rama. Por, ndryshe nga ai kryeministri kosovar, Haradinaj u shpreh i prerë se kufijtë e Kosovës nuk do të ndryshojnë. "Asnjë metër e Kosovës nuk merret më, as te Ramushi, Rama apo Thaçi. 17 shkurti nuk preket më. E kemi marrë prej vullnetit të lirë. Kur të jetë gati Serbia të na njohë, mirë se të vijë; po s'na njohu, ne nuk merrzimë", tha Haradinaj.

### Kreu i "Biznes Albania" paraqiti kërkesat në komision

## Luan Bregasi: Të ulët çmimi i energjisë dhe ujit për biznesin

Biznesi i kërkon qeverisë që të pranohet propozimin e disa deputetëve socialistë për të rritur fashën e pagave të patatueshme nga 300 mijë në 400 mijë lekë. Gjatë fjalës së tij në mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, ku po diskutohet projekt-buxheti për vitin 2019, presidenti i "Biznes Albania", Luan Bregasi u shpreh se rritja e fashës së taksimit të pagave do të sjellë formalizim të vendeve të punës dhe shmangie të evazionit. "Shqipëria ecën më mirë me taksa më të ulëta. Në lidhje me propozimin për rritjen e fashës së taksimit të pagave është një lajm i mirë. Rritja e fashës së tatueshme është një lajm i mirë se do shmanget evazionet kompanitë

**KERKESAT**  
Rritja e fashës së taksimit të pagave do të sjellë formalizim të vendeve të punës dhe shmangie të evazionit. "Shqipëria ecën më mirë me taksa më të ulëta. Në lidhje me propozimin për rritjen e fashës së taksimit të pagave është një lajm i mirë. Rritja e fashës së tatueshme është një lajm i mirë se do shmanget evazionet kompanitë që kanë pagat nga 30 deri në 40 mijë lekë të reja", tha Luan Bregasi



Presidenti i "Biznes Albania", Luan Bregasi

që kanë pagat nga 30 deri në 40 mijë lekë të reja", tha Luan Bregasi. Një tjetër çështje e ngritur nga Luan Bregasi ishte edhe kostoja e ujit dhe energjisë. Sipas tij, qeveria duhet të rishohë

mundësinë që të bëjë një diferencim të çmimit të ujit dhe energjisë për bizneset. "Shoqatat kanë bërë shumë propozime, por jo të gjitha janë marrë parasysh. Ne kemi bërë një letër që ia kemi dë-

guar edhe kryeministrit Edi Rama. Energjia dhe uji janë kosto shumë të larta për industrinë dhe biznesin në përgjithësi. Ne ju kemi mirëkuptuar, pasi humbjet ishin të mëdha. Mendoj se ka

ardhur koha që të këtë diferencim për biznesin për ujin dhe energjinë elektrike. Ne paguajmë dyfish çmimin në krahasim me popullatën, ndërsa duhet të ishte e kundërta. Jemi shumë të

ngarkuar sa i përket akcizës. Unë jam i ndërgjegjshëm që qeveria s'ka mundësi të bëjë lëvizje të mëdha, por disa lëvizje të vogla mendoj se mund të bëhen", shtoi Luan Bregasi.

Shoqata e Ndërtuesve u shpreh se taksa e infrastrukturës ka rritur kostot e ndërtimit

# Taksa mbi ndërtimin ka rritur me 100 euro m<sup>2</sup> të apartamenteve

Bizneset kërkuar bërjen 0 të taksës mbi dividendin

Ndërtuesit ankohen se taksa e infrastrukturës ka rritur kostot e ndërtimit dhe për rrjedhojë edhe çmimet e apartamenteve. Të fuar në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave për të paraqitur vlerësimet e tyre lidhur me projektbuxhetin e vitit 2019, përfaqësues të Shoqatës së Ndërtuesve kanë ngritur si shtetësim se taksa e infrastrukturës ka sjellë një rritje prej afro 100 euro për metër katror për të gjitha apartamentet e reja që ndërtohen në Tiranë. Vlerë kjo që sipas tyre shkarkohet direkt të blerësit, pra qytetarët. "Taksa e infrastrukturës që i paguhet bashkisë është 8 për qind mbi çmimin e shitjes. Ky ndikim është i barabartë me një rritje prej 20 për qind mbi çmimin e koston. Pra, në rast se sot ndërtohet në Tiranë me 400 euro për metër katror, shtohen edhe 100 euro që shtohen direkt dhe që do t'i paguajë konsumatori, pasi ndërtuesi nuk ka tjetër ku t'i shkarkojë", tha Luigj Aleksi nga Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë. Gjithashtu, ai ngriti edhe si problematikë 3 për qindëshin që duhet të paguajnë ndërtuesit për strehim social. "Problemi i dytë është 3 për qindëshin i strehimit social, i cili është i barabartë me 20 për qind e fitimit neto që ka një shoqëri ndërtimi nga ndërtimi një godine për shitje. Ndërtuesit i bëhet diskriminim sepse është i vetmi sektor që ngarkohet me këtë taksë", shtoi Aleksi. Ndërkohë që edhe përfaqësuesit e bizneseve të fushave të tjera ndonëse vlerësuat disa risi që sjell buxheti dhe paketa fiskale 2019 në disa drejtime, ngritën një sërë shtetësimesh dhe bënë disa propozime që sipas tyre do rrisin edhe më tej konkurrencën e bizneseve shqiptare me ato të rajonit. Përfaqësuesja e Dhomës Italiane të Tregtisë kundërshtoi



Luigj Aleksi

### KËRKESAT E BIZNESIT

- Ulje e çmimit të energjisë
- Ulje e çmimit të ujit
- Rishikimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë.
- Rishikimi i 3 për qindëshit për strehim social.
- Rishikimi i taksës së dheut.
- Rishikimi taksës së pronës për pallatet stok.
- Rritja e fashës nga 300 në 400 e pagës së tatueshme.
- Të shtohet në buxhet një zë për mbejet organike të kafshëve.
- Rishikimi i ligjit për vendosjen e kamerave të sigurisë për biznesit.
- Bërja zero e taksës mbi dividendin për sipërmarrjet
- Heqja e tatimit në burim për faturat për shërbimet që kryhen jashtë territorit.

detyrimin me ligj të bizneseve për të vendosur kamera sigurie. Sipas saj, kjo është një taksë e fshehtë me të cilën qeveria ka ngarkuar me pa të drejtë biznesin. "Kanë lindur një sërë ligjesh, që edhe pse nuk shprehen në formën e një takse formale, por përfaqësojnë një taksë të fshehtë për ndërmarrjet. Për shem-

bull, taksa për sigurinë publike. Ky ligj është miratuar në 2016, është një taksë, sepse përshfin të gjitha bizneset që kanë një xhiro mbi 10 mln lekë me detyrimin që ata të vendosin në ambientin e biznesit telekamera dhe të kenë një siguri private", tha përfaqësuesja e Dhomës së Italiane të Tregtisë. Dhoma Ameri-

kane e Tregtisë përshëndeti vendimin e uljes së taksës së dividendit nga 15 në 8, por kërkoi që ajo të shkojë edhe më tej për ta zëruar atë. "Ulja e taksës dividendit është pozitive, por ne duhet të jemi konkurrent me rajonin dhe nëse ne do shkojmë në 8 për qind, Kosova është me 0. Kështu që ne duhet të heqim sa më shumë pengesa për investimet që duhet të bëhen në Shqipëri", tha Mark Crawford nga Dhoma Amerikane e Tregtisë. Gjithashtu Dhoma Amerikane nuk ishte dakord as me nismën e qeverisë për të taksuar aksionet e kompanive të huaja në Shqipëri që tregtohen në bursa, për këtë kërkoi që të hynte në diskutime me Ministrinë e Financave. "Nuk mbahet tati në burim për faturat për shërbimet që kryhen jashtë territorit të një shteti", tha Alketa Uruçi nga Dhoma Amerikane e Tregtisë.

**NDËRTUESIT**  
"Problemi i dytë është 3 për qindëshin i strehimit social, i cili është i barabartë me 20 për qind e fitimit neto që ka një shoqëri ndërtimi nga ndërtimi një godine për shitje. Ndërtuesit i bëhet diskriminim sepse është i vetmi sektor që ngarkohet me këtë taksë", shtoi Aleksi.

### Braçe: Ritvan Bode është thjesht kandidat, jo anëtar i bordit

Propozimi i Ridvan Bodes nga qeveria për anëtar të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë pritet të kalojë përmes një debati mes deputetëve të Partisë Socialiste. Këtë e la të kuptohet kryetari i Komisionit të Ekonomisë, Erjon Braçe, i cili gjatë një komunikimi dje me gazetarët paralajmëroi se ai mbetet ende një propozim. Madje, ai me ironi bëri të ditur se bëhet fjalë për Bordin Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë, pra një institucion shumë të rëndësishme dhe jo për bordet e kullimit të tokave. "Gjithsecili që vjen në Komisionin e Ekonomisë dhe në Kuvend është kandidat. Nëse jeni mësuar me faktin që ai që propozohet u bë, e keni gabim. Në këtë komision ka ndodhur që janë rrezuar mbi 20 kandidatura në grup, njëri pas tjetrit individualisht për institucione të rëndësishme. Vlerësim për asnjë individ unë nuk kam, vlerësimin e bën komisioni", tha Braçe.

### Komisioni i Ekonomisë shqyrton sot dekretin e Metës për KLSH-në

Komisioni i Ekonomisë do të marrë sot në shqyrtim dekretin e Presidentit të Republikës, Ilir Meta për zgjedhjen e kryetarit të ri të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ndonëse jo me shumë ngut, mazhoranca ka vendosur që ta fusë në kalendarin e punimeve të komisionit parlamentar dhe me shumë mundësi pritet që kandidatura e Vitore Tushës të kalojë të enjten e ardhshme në seancë plenare. Nuk dihet ende se cili është qëndrimi që do të mbajnë socialistët ndaj këtij dekreti, ndonëse ata kanë paralajmëruar rrezimin e saj. Kjo jo si një kandidatë që nuk plotëson kriteret, por sepse zgjedhja e saj në KLSH do ta linte Gjykatën Kushtetuese me vetëm 1 anëtar dhe do të bëhej pengesë për funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, ku Tusha është anëtare automatikisht.

Vrasja në Bllok/ Zbardhet dëshmia e mikut të komandos Mevjol Billo në polici

TIRANË

Kur kanë kaluar thua jse dy muaj nga ngjarja e rëndë në ish-Bllok, zbardhet dëshmia e një tjetër personi të pranishëm. Ajaks Boshnjaku ka deklaruar përpara uniformave blu se nuk ka lidhje me konfliktin dhe se është larguar nga bari sapo ka nisur përleshja. Mbrëmjen e së dielës, Boshnjaku është dorëzuar në polici, i shoqëruar nga avokatja e tij. Ajaks Boshnjaku rezultoi se ka pasur lidhje miqësore me Ervin Matën, por edhe një miqësi të ngushtë me komandon Mevjol Billo, i cili është i dyshuari kryesor për shkëmbimin e zjarrit me viktimën dhe të plagosurit, të cilët ishin miq me njëri-tjetrin. Bëhet me dije se Boshnjaku është një emër i padëgjuar më herët se të ndodhte ngjarja e rëndë në ish-Bllok. Urdhër arresti për të është firmosur nga dy prokurorë, nën dyshimin se është i përfshirë në një mënyrë a tjetër në ngjarje. Boshnjaku është mik me Ervin Matën, shpallur në kërkim më datë 4 tetor 2018, pas ngjarjes së ndodhur në një nga zonat VIP të Tiranës. Nga hetimet që janë bërë, rezultoi se ai ka qenë i pranishëm në lokal në momentin që komando Mevjol Billo iu kundërpërgjigj sulmit me armë nga ana e Fabian Gaxhës. Bilo për rrjedhojë la të vdekur Gaxhën, kurse ka plagosur Ervin Martinajn dhe Elio Hatën, që njihje edhe me emrin Esmerald. Ajaks Boshnjaku ka deklaruar ditën e djeshme se nuk ka asnjë lidhje me ngjarjen ku u arrestua Ervin Martinaj dhe Elio Hato, ndërsa janë shpallur në kërkim nga policia Ervin Mata dhe miqtë e tij, Ajaks Boshnjaku, Fabio Allushi dhe komando Mevjol Billo, që dyshohet të jetë edhe autor i vrasjes së Fabian

# "Jam larguar përpara se të niste përleshja, nuk jam i përfshirë në ngjarjen e Bllokut"

Prokuroria: Ajaks Boshnjaku, prezent në momentin e vrasjes së Fabian Gaxhës



Ajaks Boshnjaku

## "BURG PA AFAT" PËR MARTINAJN

Gjykata e Apelit ka rrëzuar masën e Gjykatës së Shkallës së Parë, e cila kishte vendosur burg për 30 ditë për Ervin Martinajn, duke vendosur masën e sigurisë "burg pa afat" për biznesmenin e përfshirë në konfliktin e 4 tetorit.



Gaxhës. Mbrëmjen e 4 tetorit Tirana u trondit nga një konflikt që degjeneroi në përdorimin e armëve. Ervin Mata, partneri i këngëtares Elvana Gjata është futur në bar "Monopol" i shoqëruar nga Geldo Hoti (Liçaj), Fabio Allushi, Mevjol Bilo. Pak kohë më pas në ambientet e lokalit është futur edhe Ervin Martinaj, i shoqëruar nga shtetasi Eljon Hato, Fabian Gaxha dhe një person

ende i paidentifikuar. Kanë mjaftuar pak sekonda që konflikti verbal të sjellë një përplasje me armë, nga ku u shënuan dhe një viktimë dhe dy të plagosur. Për ngjarjen e ish-Bllokut, ku mbeti i vrarë Fabian Gaxha janë arrestuar 3 persona: Ervin Martinaj, Eljon Hato dhe Geldo Hoti, ndërsa në kërkim janë Ervin Mata, Fabio Allushi, Mevjol Bilo. Gjykata e Apelit ka rrëzuar

vendimin e një gjykate më të ulët, asaj të Shkallës së Parë të Tiranës, e cila kishte kërkuar "arrest me burg" me afat 30-ditor për Ervin Martinajn. Në një seancë të zhvilluar me detyrë të mbyllura, Apeli ka ndryshuar masën e sigurisë në "arrest me burg" pa afat për Martinajn, edhe pse avokati mbrojtës i tij kishte apeluar, me synimin për të lehtësuar barrën ndaj klientit të tij.

Ngjarja në ish-Bllok, edhe dy persona të përfshirë në konfliktin me armë. Policia dhe Prokuroria, drejt identifikimit

Pas ngjarjes në ish-Bllok, u arrestuan tre persona si dhe u shpallën në kërkim 4 të tjerë. Megjithatë, prokuroria dhe policia bëjnë me dije se janë edhe dy persona të përfshirë dhe po punohet për identifikimin e tyre. Ervin Martinaj, Eljon Hato dhe Geldo Hoti janë arrestuar nga policia, ndërkaq vijojnë të jenë në kërkim Ervin Mata, Fabio Allushi, Mevjol Bilo, si persona të përfshirë në ngjarje. Më tej policia ka shpallur në kërkim edhe këngëtares Elvana Gjata,

e cila dyshohet se ka dijeni mbi rrethanat e ngjarjes së rëndë. Megjithatë, bëhet me dije se që pas përplasjes me armë, ajo është larguar nga Shqipëria. Ndërkaq, shtetasi Ajaks Boshnjaku, i cili ishte në kërkim është dorëzuar mbrëmjen e së dielës në ambientet e policisë së Tiranës, duke dhënë deklaratën për përfshirjen e tij në konfliktin e 4 tetorit. Sipas hetimeve, Boshnjaku ka qenë në momentin kur komando Mevjol Bilo iu kundërpërgjigj sulmit me armë nga Fabian Gaxha, duke lënë të vrarë këtë të fundit dhe duke plagosur Ervin Martinajn dhe Elio (Esmerald) Haton. Nga deklaratimet e tij në polici, Boshnjaku e hedh poshtë këtë version, duke deklaruar se është larguar përpara se të niste shërri. Të njëjtat burime nga grupi hetimor thonë se janë edhe të paktën dy persona të tjerë, të cilët kanë qenë prezentë kur ndodhi ngjarja e rëndë si pjesë e grupeve që kanë hyrë atë natë në lokal. Organet e hetimit ende nuk kanë mundur të dalin me një emër sa u përket këtyre personave, pasi janë ende nuk bërë verifikimet përkatëse.



## Trafiku i drogës nga Shqipëria, goditen 2 grupe trafikantësh në Itali, 30 në pranga

ITALI - Goditet një rrjet i trafikut të drogës, i cili transportonte sasi të madhe narkotikësh nga Shqipëria në drejtim të Italisë. Mediat italiane raportojnë se nga 55 persona që janë vënë nën hetim, ndërsa 41 prej tyre kanë përfunduar në pranga. Mësohet se ata janë hetuar për gjatë dy vitesh nga 2015-2017. Pas arrestimit dhe goditjes së grupit të trafikantëve, togat e zeza kanë dhënë menjëherë masën e sigurisë, teksa 30 janë lënë në burg dhe 11 të tjerë në "arrest shtëpie". Nga ky operacion raportohet se janë goditur dy grupe kriminale, mes tyre edhe shqiptarë, por nuk jepet detaje për gjeneralitetet e tyre. Aksioni për arrestimin e tyre, i koduar "Mesazh i shkurtër", u zhvillua në Pulia, Leçe, Brindisi dhe në disa zona të Barit.



## "Lekë të kapura në loto dhe kontakte me botën e krimit"

### Vetingu shkarkon prokurorin e Bashës dhe gjyqtarin e Shkodrës

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka shkarkuar nga detyra ditën e djeshme prokurorin në Prokurorinë e Përgjithshme, Artur Selmani, pasi nuk justifikoi pasurinë. Sipas asaj që ka deklaruar pranë ILDKPKI-së, rezultoi se në vitin 2004, Selmani ka deklaruar të ardhura nga paga prej 1.4 milionë lekësh. Gjithashtu, ai pretendon se ka fituar shumën 10 mijë dollarë në baste sportive. KPK duke iu referuar DSIK thotë se Selmani është i papërshtatshëm për të vijuar detyrën, pasi ndaj tij ka pasur ankesë nga famil-

**ARTUR SELMANI**  
"Kam hetuar Lulzim Bashën për tenderin e pasaportave Ndreun dhe Arben Ndoken kur u godit një deputet. Prokurori i Përgjithshëm më urdhëroi të publikoja videon kur u godit një deputet. Më larguan, më transferuan te Prokuroria e Tiranës".

jarët e viktimave në Çole të Vlorës. Familjarët pretendojnë se prokurori Selmani ka lehtësuar akuzën për të pandehurit. Prokurori ka thënë në seancë se ai ka hetuar ngjarje të vitit 1997 si

dhe Lulzim Bashën për tenderin e pasaportave. "Kam hetuar Lulzim Bashën për tenderin e pasaportave, Ndreun dhe Arben Ndoken, kur u godit një deputet. Prokurori i përgjithshëm më urdhëroi të publikoja videon kur u godit një deputet. Më larguan, më transferuan te Prokuroria e Tiranës. Unë po mbroja interesat e të pandehurëve", - ka thënë ai. Ndërkaq, vetingu ka shkarkuar ditën e djeshme edhe gjyqtarin e Shkodrës, Luan Dervishi. Shkarkimi i gjyqtarit është bërë për shkak se sipas DSIK, ai ka rezultuar me kontakte me botën e krimit



të organizuar. Gjithashtu, nga hetimet e kryera dhe informacionet e sjella nga ILDKPI, u bë e ditur se Dervishi ka kryer deklaratim të rremë të pasurisë. Gjyqtari ka mospëruar të deklaronte për blerjen e një apartamenti në Tiranë. Sipas komisionit, Luan Dervishi nuk ka shlyer tatimet edhe për një apartament që kishte lëshuar me qira.

## PASIGURIA 'ONLINE'

### INTERVISTA

Drejtori i "CRCA Albania": Të rinjtë kanë dashur të kryejnë vetëvrasje pas abuzimit 'online'

# Mbi 200 të mitur denoncojnë rastet e përndjekjes nëpërmjet rrjeteve sociale

## Haziaj: Fëmijët, të predispozuar për të rënë në grackën e pedofilëve

Voltiza Duro

**N**umri i fëmijëve dhe adoleshentëve që përndiqen nëpërmjet internetit po rritet ditë-ditë. Brenda dy viteve të fundit janë evidentuar më shumë se 200 raste që kanë bërë denoncimin në platformën "ISIGURT.al". Shifrat zbardhen nga Altin Haziaj, drejtor i përgjithshëm i "CRCA Albania" (Children's Human Rights Centre of Albania), i cili shton se forma më e shprehur e përndjekjes është nëpërmjet videove të shpërndara në "Youtube". Në pjesën dërrmuese të denoncimeve janë vajzat, të cilat bien pre e përndjekjes 'online'. Haziaj bën me dije se duhen marrë një sërë masash, në mënyrë që fëmijët dhe adoleshentët të mos bien në grackën e pedofilëve dhe grabitqarëve seksualë. Të dhënat kudo në botë tregojnë se fëmijët kontaktohen në një masë tepër të lartë nga persona të rritur të panjohur në internet.

**Prej sa kohësh është krijuar qendra e sigurt e internetit dhe cili është misioni i saj?**

Puna e mirëfilltë për Qendrën Kombëtare për Internetin e Sigurt në Shqipëri ka nisur në vitin 2016 dhe vijon e forcohet edhe më tej, për shkak sepse në këto dy vjet kemi krijuar më së fundi një databazë dhe hartë të rasteve të internetit të pasigurt në Shqipëri dhe jemi duke punuar me autoritetet sesi t'i adresojmë shqetësimet e fëmijëve dhe të rinjve, që kërkojnë që të jenë sa më të mbrojtur dhe më të sigurt gjatë navigimit në internet. Qëllimi i qendrës është që të promovojë ligje, politika dhe praktikat më të mira për ta bërë internetin, në një mjeshtëri të sigurt për fëmijët dhe të rinjtë dhe ku asnjë fëmijë të mos kthehet në një viktimë të dhunës, abuzimit dhe pedofilisë 'online'. Qendra ka si qëllim gjithashtu që të



forcojë kapacitetet dhe të rrisë informimin e të gjithë përdoruesve të internetit në lidhje me të mirat, por edhe rreziqet me të cilat ndeshemi dhe si mundet që së bashku të ndërtojmë një klimë respekti dhe mbrojtjeje për këdo që ka qasje në botën virtuale.

**Si funksionon kjo qendër?**

Qendra funksionon si një platformë raportimi të çdo rasti kur fëmijët dhe të rinjtë ndeshen me internet të pasigurt, me përmbajtje të papërshtatshme, me pornografi të fëmijëve, kur profilet, fotot apo emrat e tyre përdoren dashakeqasi nga persona të njohur ose jo në internet etj. Platforma "www.ISIGURT.al" bën të mundur për këdo, nëpërmjet aplikacionit në celular apo faqes së internetit, që të denoncojnë raste të tilla dhe më pas stafi ynë i specializuar vendos sesi do të ndiqen këto raste. Në shumicën e rasteve në kontaktim direkt me kompanitë globale si "Facebook", "Twitter", "Youtube" etj., apo kur ato janë në Shqipëri lidhemi me to direkt. Nëse materiali i publikuar 'online' përbën edhe një material të paligjshëm, atëherë

ne ia kalojmë atë për ndjekje Policisë së Shtetit, me të cilën kemi një bashkëpunim të shkëlqyer për këto raste.

**Sa është numri i rasteve që denoncojnë te ju deri më tani?**

Që nga 2016, me hapjen e platformës "www.ISIGURT.al" janë raportuar më shumë se 200 raste të fëmijëve dhe adoleshentëve. Nga këto 65 raste të verifikuara i përkasin vitit 2016, 17 raste vitit 2017 dhe 53 raste deri në nëntor për vitin 2018. Numri i adoleshentëve që raportojnë këtë ngjarje është rritur dhe ndërkohë muajt e fundit janë shtuar edhe të rriturit që na raportojnë po të njëjtin shqetësim. Si duket qenia në një botë virtuale iu krijon bindjen disa njerëzve që mund të ndahet çdo lloj mesazhi apo imazhi 'online', ndërkohë që ligji shqiptar nuk është i qartë në këtë drejtim, pra a dënohen apo jo. Për këtë fakt ne duam që Kodi Penal të amendohet që të përfshijë sjelljet e dënueshme si 'online', ashtu edhe në jetën e përditshme. Shqipëria ka nevojë që të kriminalizojë

### SHIFRAT

Që nga 2016, me hapjen e platformës "www.ISIGURT.al" janë raportuar më shumë se 200 raste të fëmijëve dhe adoleshentëve. Nga këto 65 raste të verifikuara i përkasin vitit 2016, 17 raste vitit 2017 dhe 53 raste deri në nëntor për vitin 2018. Numri i adoleshentëve që raportojnë këtë ngjarje është rritur dhe ndërkohë muajt e fundit janë shtuar edhe të rriturit që na raportojnë po të njëjtin shqetësim.

disa sjellje 'online', sepse ato dëmtojnë fëmijët e të rinjtë dhe shpesh kthehen në rreziq serioz për jetën dhe mirëqenien e tyre. Marrim rastin e sexting - dërgimit të mesazheve/ imazheve me natyrë seksuale.

**Cilat janë grupmoshat më të prekura?**

### PASOJAT

Ndikon po njësoj sa dhuna dhe abuzimi në jetën reale. Në dy raste të fëmijëve që kemi ndjekur, ka pasur tentativa për vetëvrasje nga ana e tyre dhe na është dashur që jo vetëm të flasim me ta, por edhe me familjarët, për ta ndjekur rastin me shumë kujdes dhe për të marrë mbi të gjitha ndihmën e duhur psikologjike dhe mbështetje emocionale maksimale në familje.

Grupmosha më e prekur është ajo e adoleshencës. Kemi një numër gjithnjë më të rritur të rasteve të adoleshentëve që ose vetëspozohen ose ekspozohen nga miqtë e të njohurit e tyre në një kontekst seksual, keqdashës, apo në një kontekst ku dhuna e ushtruar ndaj



Foto ilustruese

tyre kthehet në një histori virale në "Youtube" dhe shpërndahet kudo në rrjetet sociale. Gjatë vitit të fundit kemi marrë raportime në rrjetet për profile dhe foto të vjedhura në "Instagram" apo profile false që pretendojnë të jenë një fëmijë tjetër. Bulizmi 'online' mbetet një ndër problemet më të mëdha. Në një rast na është dashur 17 herë të raportojmë të njëjtin profil, sepse sa herë që bllokohej video, aq herë e hidhte 'online' të njëjtin video. Urrejtja e disa njerëzve ndaj fëmijëve apo adoleshentëve ndonjëherë është kaq e madhe dhe e pakufishme, gjë që në fakt kërkon trajtim dhe zgjidhje specifike, jo thjesht me bllokime 'online', por sidomos nëpërmjet dënimeve ligjore në gjykatë.

**Cilat janë format e përndjekjes më së shumti?**

Forma më e shprehur e përndjekjes është nëpërmjet videove të shpërndara në "Youtube" dhe përgjithësisht janë vajzat që bien më së shumti viktimë. Ndërkohë që vetëm gjatë muajit nën-

dhe t'i kthejnë ato në modele të përgjithshme. Këtu ne mendojmë se lind edhe rreziq më i madh, nëse nuk arrijmë që ligjërisht dhe institucionalisht t'i ndjekim deri në fund raste të tilla, pasi ato mund të kthehen edhe në modele biznesi për dikë që mund të dojë të përfitojë financiarisht apo seksualisht nga dobësia njerëzore. Sot nuk ka nevojë të kesh një pistoletë në dorë për të detyruar dikë të bëjë seks me ty! Mjafton një foto e papërshtatshme dhe ajo mund të kthehet në një shkak për dhunë dhe shfrytëzim seksual apo edhe financiar. Kush nuk ka mundësi, vendoset përpara dilemës të vrasës veten apo të përballat me dhunë e buliz të dyfishtë nga familja e shoqëria. Kjo është arsyeja që ne i ftojme fëmijët dhe adoleshentët që e para të denoncojnë çdo rast të tillë dhe e dyta, të informojmë çdo prind, mësues, fëmijë, adoleshent, institucion etj., që navigimi 'online' nuk duhet të jetë një lundrim ku çdo moment mund të shpërthejë një minë. Interneti duhet të jetë i sigurt për këdo!

**Nga cilat qytete vijnë më së shumti denoncimet?**

Qytetet e mëdha mbajnë peshën kryesore sigurisht, si Tirana, Durrësi, Vlora, Elbasani etj., por për habinë tonë, Peshkopja gjatë vitit 2018 na rezultoi thuajse po aq problematike sa kryeqyteti. Kjo për ne ngre kambanat e alarmit, pasi numri i rasteve për numër popullsie është tepër i lartë, gjë që mund të tregojë se mbase në këtë qytet ka një rrjet të organizuar të keqbehësve ndaj fëmijëve, të cilët mundohen të krijojnë sa më shumë përfitime për veten të bazuara tek abuzimi i fëmijëve dhe adoleshentëve nëpërmjet internetit.

**Si ndikon në psikologjinë e adoleshentëve ky lloj abuzimi virtual?**

Ndikon po njësoj sa dhuna dhe abuzimi në jetën re-





ale. Në dy raste të fëmijëve që kemi ndjekur, ka pasur tentativa për vetëvrasje nga ana e tyre dhe na është dashur që jo vetëm të flasim me ta, por edhe me familjarët, për ta ndjekur rastin me shumë kujdes dhe për të marrë mbi të gjitha ndihmën e duhur psikologjike dhe mbështetje emocionale maksimale në familje. Përtej kësaj, ka një fakt që ende nuk diskutohet në Shqipëri, që është e drejta për t'u harruar! Nëse ne nuk e gjejmë dot se ku ndodhet personi që hedh një video abuzuese 'online' etj. dhe nëse ne nuk e ndëshkojmë këtë person, përfshi edhe sekues-trimin e të gjitha materialeve abuzuese/ kërcënuese, do të thotë që ky person në çdo moment mund ta hedhë videon 'online' në rrjete sociale etj., etj. Edhe kjo si çështje kërkon një trajtim ligjor të kujdesshëm, sepse një fëmijë apo adoleshent nuk duhet të ndehet i/e kërcënuar gjithë jetën e vet vetëm sepse ndau psh., një foto intime dhe dikush keqpërdori këtë besim. E drejta për t'u harruar në botën virtuale do të thotë që gjykatat duhet të vendosin që materiale të tilla të shkatërrohen edhe virtualisht, siç bëhej një herë e një kohë me negativët e filmave apo materiale të tjera të printuara.

#### **Cilat janë masat që mund të merren për parandalimin e fenomenit?**

Vetë fëmijët dhe adoleshentët duhet të jenë më të informuar në lidhje me atë sesi mund të mbrohen në botën virtuale 'online'. Adoleshentët do të vijnë ta eksplorojnë seksualitetin e tyre 'online' dhe 'offline', por kjo nuk duhet t'ju sjellë atyre dëm. Në këtë aspekt ne duhet të krijojmë një kozmos të ri për botën dhe jetën tonë virtuale, ku fëmijët mbi të gjitha të mos gjenden të atakuar, siç janë sot, nga pedofilët dhe grabitqarët seksualë. Të dhënat kudo në botë

tregojnë se fëmijët kontaktohen në një masë tepër të lartë nga persona të rritur të panjohur në internet. Kjo do të thotë që vetë prindërit duhet të rrisin kujdesin ndaj fëmijëve, duke kufizuar orët që fëmija shpenzon në internet dhe vendin ku ai e akseson internetin. Po ashtu, prindi duhet të jetë në dijeni se ku ndodhet fëmija dhe me kë, nëse nuk është me prindin. Mësuësit kanë nevojë të kuptojnë një luajnë një rol të pazëvendësueshëm në jetën e fëmijëve, ndaj duhet të jenë të përgatitur që t'asistojnë fëmijët me çdo informacion. Për këtë qëllim, ne kemi krijuar edhe udhëzues të posaçëm në platformën "www.ISIGURT.al", që vetë fëmijët, prindërit, mësuësit, sistemi i mbrojtjes së fëmijëve, të gjejnë udhëzues të thjeshtë dhe praktikë sesi t'i mbrojnë fëmijët në internet. Ndërkohë që thirrja jonë kryesore për fëmijët dhe prindërit është gjithnjë: **DE-NONCO!** Platforma është 'online', por njëkohësisht kushdo mund të marrë në telefon falas edhe pranë 'ALO 116-111' për të denoncuar raste të tilla ose pranë policisë së shtetit. Së fundmi, Kuvendi, ligjvënësit dhe institucionet duhet të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre. Policia e Shtetit ka nevojë serioze që të riorganizohet dhe të ketë një drejtori të veçantë me prezencë në të 12 qarqet për krimet kibernetike, pasi jeta virtuale dhe krimi në të janë kthyer në një realitet që nuk mund ta neglizhojmë më. Nga ana tjetër, ne po punojmë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që së bashku të ngremë një mekanizëm konsultativ kombëtar, ku të sjellim së bashku institucionet, shoqërinë civile dhe industrinë e internetit, për të gjetur zgjidhjet më të mira ligjore dhe praktike, për ta bërë internetin të sigurt për këdo!

"CRCA Albania": Shqipëria, shesh beteje për të drejtat. Bashkitë, fajtoret kryesore

## Statistikat e frikshme, mbi 106 gra të vrara gjatë 8 viteve të fundit

**INSTAT: 750 mijë gra e vajza, të dhunuara të paktën një herë**

Voltiza Duro

Në vendin tonë këto 8 vitet e fundit kanë humbur jetën 106 gra dhe vajza, viktimat të dhunës në familje, 73 prej të cilave janë vrarë nga bashkëshortët e tyre. Ndërkohë, gjatë vitit 2018, plot 16 gra dhe vajza nuk i mbijetuan dhunës në familje në një kohë që janë dhënë mbi 4000 urdhra mbrojtje nga gjykatat. "Që prej vitit 2010 në Shqipëri, në 90 për qind të vrasjeve autorët janë meshkujt. Vajzat dhe gratë përbëjnë thuajse gjysmën e popullsisë me një popullsi rreth 1,431,714 persona (INSTAT). Në Shqipëri dhuna në familje vazhdon të jetë e përhapur në të gjitha shtresat e shoqërisë. Sipas INSTAT/UNDP, mbi 53% e tyre, ose rreth 750 mijë gra dhe vajza në Shqipëri deklarojnë se kanë qenë të paktën një herë në jetën e tyre viktimat të dhunës në familje. Përmasat e dhunës në familje janë edhe më të mëdha, pasi pjesa më e madhe e rasteve nuk denoncohen, për shkak sepe viktimat e shohin dhunën në familje si një çështje private". - thuhet në deklaratën e shtëpisë së të drejtave të njeriut. "CRCA Shqipëri", një ndër organizatat kryesore të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve në vend, në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizimit për eliminimin e dhunës me bazë gjinore, me anë të këtij reagimi publik, ka shprehur shqetësimin e saj për situatën e rëndë të dhunës ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri. "Shqipëria po kthehet në një shesh beteje për të drejtat e grave dhe vajzave! Nga njëra anë kemi një lëvizje gjithnjë në rritje të shoqërisë për arritjen e barazisë burrë-grua, por nga ana tjetër vlerat tradicionale dhe kulturore që e shikojnë dhe e trajtojnë vajzën dhe gruan si pronë prodhojnë dhunë dhe vrasje! Në këtë drejtim, përgjegjësi kryesore mbajnë bashkitë kudo në Shqipëri, pasi në 28 vjet nuk kanë arritur të ndërtojnë thuajse asnjë shërbim komunitar për fuqizimin e familjeve dhe zgjidhjen e konflikteve", - tha Altin Hazizaj, drejtor i CRCA dhe anëtar i Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore në Shqipëri. Raportet kombëtare



#### **FEMRAT E VRARA NE 2018-ën**

- 20 janar 2018, vritet pranë Fakultetit të Mjekësisë, studentja 22-vjeçare A.M., në Tiranë.
- 21 janar 2018, vritet në shtëpinë e saj, 73-vjeçarja S.H., në qytetin e Vlorës.
- 5 prill 2018, vritet Z.T., 68 vjeçe, nëna e 6 fëmijëve në shtëpinë e saj.
- 27 prill 2018, vritet në shtëpinë e saj, gruaja S.SH., 58-vjeçare në Shkodër.
- 27 maj 2018, vritet 52-vjeçarja E.T. në shtëpinë e saj, pas shumë goditjeve vdekjeprurëse.
- 30 maj 2018, vritet në automjetin e saj, 34-vjeçarja, F.N., madje në sy të fëmijës së mitur.
- 7 qershor 2018, vritet në shtëpinë e saj nga djali, nëna 50 vjeçe, Z.S. në Peshkopi.
- 8 qershor 2018, vritet në shtëpi, 40-vjeçarja, A.Sh., nëna e 6 fëmijëve.
- 9 qershor 2018, duke shkuar në shkollë për të, vritet në mes të rrugës 18-vjeçarja XH. Ç..
- 10 qershor 2018, vritet dhe hidhet në rrugë, trupi i 20-vjeçares, A. M..
- 4 korrik 2018, vritet në banesën e saj 61-vjeçarja S. L.. në Elbasan.
- 15 korrik 2018 vritet në Shkodër pranë fëmijës 1 vjeç, S.N. vajza 25-vjeçare.
- 10 gusht 2018, vritet Perrie Zykaj, 78 vjeç; Vasiliqa Zykaj 40 vjeç; Sara Zykaj, 15 vjeç dhe Afërdita Zykaj 47 vjeç.

tregojnë se viktimat e dhunës në familje përballen çdo ditë me mungesa në shërbime apo edhe indiferencën e institucioneve shtetërore. Sipas CRCA-së, shërbimet në familje apo ato komunitare pasi ndodh dhuna, janë thuajse inekzistente, pavarësisht se bashkitë e kanë për detyrë që t'i ofrojnë ato për këdo, ndërkohë që parandalimi i dhunës dhe mësimi i modeleve të reja të komunikimit dhe zgjidhjes së konflikteve që në fëmijërinë e hershme, ende nuk kanë dhënë ndonjë impakt në drejtim të eliminimit të dhunës. "Kultura e dhunës mbetet ende prevalente në shkollë, në shoqëri dhe në marrëdhëni-

et familjare. Në këtë ditë, CRCA Shqipëri i drejtojmë këtë thirrje të hapur jo vetëm qeverisë, por sidomos drejtuesve dhe përfaqësuesve të pushtetit lokal, të të gjitha bashkive në vend, të financojnë shërbime të mirëfillta komunitare për parandalimin dhe trajtimin e dhunës në familje. Nga ana tjetër, ne po i rikërkujmë Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit, ngritjen e një Programi Kombëtar për parandalimin dhe trajtimin e dhunës në shkollë, pasi shkollat janë një ndër mjediset kryesore ku manifestohen gjerësisht pasojat e dhunës në familje. 25 nëntori u zgjodh si Ditë

Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës me bazë Gjinore nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. Kjo datë përkon me vrasjen makabre të 3 motrave Mirabal në Republikën Domenikane, në vitin 1960, një vrasje kjo që u kthye në një lëvizje popullore kundër dhunës dhe që kujtohet çdo vit në të gjitha vendet e botës. Kjo ditë kërkon të ndërgjegjësojë mbarë botën dhe opinionin publik që të denoncojnë dhunën ndaj grave dhe vajzave", - thekson CRCA. Më shumë se një e treta e grave në mbarë botën kanë përjetuar dhunë fizike ose seksuale në një moment në jetën e tyre.

Zbulohet lidhja e aktorit të humorit, ja sa vite kanë bashkë

# Gaz Paja prezanton të dashurën në "Wake UP": S'ka unazë, as bashkëjetesë mes nesh

*"Jemi në proces njohjeje, ajo është ndryshe nga unë"*

Egla Xhemali

Është përfolur shumë për historinë e dashurisë me një vajzë bukuroshe bionde, mirëpo nuk ka dashur kurrë që imazhi i saj të zbulohet. E kemi fjalën për aktorin e "Portokalli", Gaz Pajën. Pak ditë më parë, aktori dhe e dashura e tij morën pjesë në ndarjen e çmimeve "Kult". Prej disa kohësh, aktori i njohur Gaz Paja është duke shijuar një histori të bukur dashurie me një vajzë shumë simpatike. Burime për "Gazeta shqiptare" kanë pohuar se çifti ka 9-10 vite bashkë, megjithëse daljet e tyre në publik kanë qenë mjaft të rralla për të qëndruar larg vëmendjes së njerëzve. Vetë Paja nuk ka preferuar të japë shumë detaje rreth bukuroshes që i ka rrembyer zemrën, por në një intervistë për emisionin "Wake Up", ai e cilësoi atë si "E bukura e dheut". Ai pranoi në atë intervistë televizive se është në një lidhje dhe ndihet shumë mirë, pa mohuar asnjë nga përshkrimet që moderatorët, Oriela Nebiaj, Eno Popi dhe Isli Islami bënë për të dashurën e tij. Sipas tyre, ajo është e bukura e dheut: "Simpatike, e bukura e dheut. Është bionde, e gjatë, e buzëqeshur, elegante, pozitive, i qeshin syçkat kur shikon Gazin", ishin përshkrimet e tyre, duke qenë se ata e njohin nga afër. Gaz Paja tregoi se është një romantik i vërtetë, se i dedikon asaj këngë dashurie. Ndërkohë, vetë Gazi ka pohuar se: "Nuk kemi akoma, as bashkëjetesë, as unazë. Jemi në procesin e njohjes, mirë po shkon. Unë jam tip impulsiv, ajo është ndryshe, që është diçka shumë e mirë. Ndihem mirë, është një vajzë që më fal qetësi, është shumë e sjellsme, e dashur, korrekte, më bën të ndihem shumë mirë". E dashura e aktorit quhet Ira dhe ka përfunduar studimet bachelor në universitetin "Aleksandër Moisiu" në Durrës. Madje, nuk kanë munguar edhe momentet super romantike si fotot që "Panorama Plus" ka publikuar disa muaj më parë, ku Gazi dhe e dashura e tij shfaqeshin duke shkëmbyer puthje të zjarrta dhe përfaqime". Gaz Paja nuk ka dashur kurrë të bjerë "pre" e mediave rozë, duke bërë të pamundurën



që pjesa e jetës së tij private të qëndrojë larg mediatizimit, mirëpo këtë herë nuk pati rrugë tjetër veç asaj të të pranuarit se është vërtetë në një lidhje dhe se po jeton ditët më të lumtura. Rikuj-

tojmë se ai është një nga aktorët më të dashur për publikun në spektaklin e humorit "Portokalli", ku ka spikatur që në fillim me role nga më të ndryshmet e sidomos me atë të Nasit.



**NOVARTIS**

Novartis Pharma Services Inc. Tirana-Albania, the Representative Office of the multi-national company, NOVARTIS, the worldwide leader in the pharmaceutical industry, wants to hire a **Marketing Assistant**.

**JOB PURPOSE:**

Offers support for the marketing activities organised by the Representative Office in Tirana-Albania.

**Some of his/her qualifications and requirements would be:**

- University degree in Marketing, Business & Administration or other areas with similar knowledge
- Extra Knowledge of medical background preferable
- Very High Proficiency in English and local language (oral and written)
- Digital literacy with technology skills (Microsoft Office package)
- Outstanding organizational and coordination skills
- Excellent communications, interpersonal and negotiation skills
- Must demonstrate ability to prioritize and handle multiple tasks in a timely fashion, with minimum supervision and efficient follow-up
- Implement with excellence the planned activities and marketing campaigns adhering to the relevant Codes of Practice/regulations.

The interested candidates are invited to send the CV-s at the e-mail address: [blerta.rambi@novartis.com](mailto:blerta.rambi@novartis.com). Deadline 30 November 2018

Only the selected candidates will be contacted.

## Oriola 'çmendi' rrjetin me fotot seksi nga Dubai, zbulohet kush është 'habibi'

**P**rej disa ditësh, Oriola Marashi është me pushime në Dubai, prej nga ku ka publikuar shumë foto e video seksi, e veshur me bikini të vogla duke ekspozuar format bombastike, por edhe duke realizuar ca lojëra me shumë adrenalinë në ujë që kanë frikësuar edhe të emën. Sërish ditën e djeshme Oriola është shfaqur në pishinë dhe ka hedhur disa foto shumë provokuese, teksa shfaqej e lagur e veshur me një palë bikini të zeza që gati sa nuk i zbuluan gjoksin. Dje, Oriola është zgjuar vonë dhe ka dalë anës pishinës, ku në videon që ka filmuar veten, ka kapur edhe parukierin e njohur Merita, me të cilën mesa duket është në këto pushime luksoze dhe e quan "Habibi" në një video që postoi në "Instastory".




## Të gjithë u fiksuan me klipin e fundit të Taynës, por shihni nga e ka kopjuar

**A**shtu siç pritej, kënga e re e Taynas "Pow Pow" u shndërrua menjëherë në hit dhe klikimet po i shtohen dita ditës. Nuk mund të mos kalohej pa reagime pasi u komentua si një diss për reperet e tjera, mirëpo siç duket ideja për klipin e këngës nuk paska qenë aq origjinale sa menduam. 'Gazeta Express' ka zbuluar detajin që e ka nxjerrë Taynën pak "bllof". Sipas tyre klipi i kësaj kënge është kopjuar nga një artist afrikan, që mban emrin Lava Lava. Në të dyja klipet shihet e njëjta skenë me murin e verdhë dhe copëza pasqyre, si dhe makina e vjetër e çmontuar me ngjyrë lejla. 'Go Gaga' është publikuar në 6 tetor të këtij viti, ndërsa kënga e Taynës në 17 nëntor.



## Adelina Tahiri i habiti të gjithë, ja çfarë ka bërë bukurshja

**A**delina tashmë nuk po ndalet së publikuari foto të bashkëshortit. Këngëtarja nga Maqedonia, Adelina Tahiri 'theu' akullin dhe përveç se po tregon shumë detaje për jetën e saj private, ajo në rrjetet sociale po e ekspozon edhe burrin e saj milioner. Këngëtarja pas lindjes, njësoj si gjatë lindjes, po shijen udhëtimet e saj të shtrenjta me të shoqin. Aktualisht po qëndron në Holandë nga ku edhe bëri një numër të madh postimesh në "Instagram". Edhe pse burri i saj është shumë më i madh në moshë, Adelina është shumë e dashuruar në të. Ajo së fundmi, ka publikuar një fotografi ku shfaqet shumë e dashuruar në krahët e burrit të saj milioner.



## Tuna rrugës me të birin për në një vend special, ku po shkojnë ata?

**T**una ka marrë djalin për një shëtitje në vendlindjen e saj. Këngëtarja po kalon ditë plot lumturi, pasi është bërë nënë. Ajo krahas kësaj, është aktive edhe më skenën muzikore dhe mundohet të jetë afër publikut edhe në rrjetet sociale, duke postuar fotografi të shumta çdo ditë. Bukuroshja nuk heziton që edhe fotografitë e djalit dhe të burrit t'i postojë në profilin e saj në Instagram. Tuna sot ka publikuar një foto ku shfaqet me djalin e saj Tianin rrugëve të Shkupit. Të veshur me shumë stil, ata kanë mahnitur me pamjen e tyre.



**SHPALLJE ANKANDI**  
Zyra Përbarimorë "E.G Bailiff Service" me përbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 14.12.2018 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i I-re për shitjen e pasurisë të paluajtshme, Arë me sipërfaqe 1500 m<sup>2</sup>, nr. 179/87, vol. 8, fq. 19 zk. 2326, në Kuman, Fier në pronësi të Z. Arben Refat Ramizi me vlerë fillestare në ankan 600.000 (Gjashtëqind mijë) Lekë. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

**SHPALLJE ANKANDI**  
Zyra Përbarimorë "E.G Bailiff Service" me përbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 14.12.2018 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i I-re për shitjen e pasurisë të paluajtshme, Trulli me sipërfaqe 1000 m<sup>2</sup> ndodhur në ZK. 2399, Nr. 281/20, Vol. 13, fq. 9 nga kjo Ndërtesë me sipërfaqe 134 m<sup>2</sup> në pronësi të Z. Ilir Alush Uku me vlerë fillestare në ankan 8.000.000 (Tetë milion) lekë. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

**SHPALLJE ANKANDI**  
Zyra Përbarimorë "E.G Bailiff Service" me përbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 11.12.2018 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i II-te për shitjen e pasurisë të paluajtshme, Apartamenti me Nr.pasuria 6/1434-1-38 me adresë "Lagja 16 Prilli" me sipërfaqe totale 120 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Nr.8534, Vol.8, Fq.161, Fier në pronësi të z.Mihal Jorgo Gjokuria me vlerë fillestare në ankan 30.240 (Tridhjet mijë e dyqind e dyzet) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com



Table with 10 columns and multiple rows containing names and numbers, organized by family names such as VANGJEL, MEHMET, FASLI, etc.

Table with 10 columns and multiple rows containing names and numbers, organized by family names such as MIHAL, VRANO, HAKIK, etc.

Table with columns: MANGELI, ZHARRA, DHEMTRA, ZHARRIA, etc. Lists names and their corresponding categories.

Table with columns: RIAT, MASJA, etc. Lists names and their corresponding categories.

Table with columns: ALI, ZEDO, AGIM, DRIN, LUAN, FATMIR, XHEVDET, PIETER, HISN, FLORENÇ, BASH, NUR, MEHMET, HVZ, NURM, Mustafa, KRISTO, ME PROKURIE, GERGI, RZA, IBRAHIM, BROK, Xhafar, LUAN, HWIDA, MUSTAFA, PETRAZ, BASMA, ROSE, FLORENÇ, RZM. Rows list names and their corresponding letters (A-Z) in a grid format.

Table with columns: GIOANIN, MIRASH, ROKHNA, VERRISHA, PABO, VERRISHA, BARDEF, BICI, LUGI, MIRASH, KOLEC, MIRASH, ZEF, GJERA, NIAD, VELI, PANDU, ZINDOVI, STARULLA, PAPA, DHCIND, RAKUSH, HETEM, HYSKA, ENGLISH, HYSKA, SYTI, ZAIM, ELERIM, ZAIM, DALIT, KURTI, SAKIE, KURTI, ORTA, KURTI, FATMIR, KURTI, SELVIE, ALLAVANI, BLIAR, DOGLI, VEHA, XHEFERI, BANO, XHEFERI, SAREJIN, XHEFERI, FARE, XHEFERI, FLORINA, XHEFERI, SOGLI, XHEFERI, BANO, XHEFERI, BEGLE, KISO, HAJMIR, KISO, NURM, KISO, ERDOL, KISO, VEI, BALLOLI, EDJE, OGBA, FELLEZE, LUNIKU, FIDMET, BALLOLI, RIKRINDO, BALLOLI, SHPESA, MERVAN, SULLTANE, BALLOLI, HYSN, GATA, HMET, GATA, ILIA, GATA, XEMVILE, CEFALIA, KRISTAQ, NUSH, ANA, RUP, BENA, NUSH, PINAVOT, NUSH, ALFONS, RADOVINI, MARGARITA, TOSKA, EDORENCA, JADVA, ANELIN, RADOVINI, NAZM, CENOLI, ZAMR, CENOLI, ZEF, PELLA, RISHRE, LINDLIPILLA, SOSE, VADANPILLA, ACE, MNI, ALI, SALLAKU, SALLAKU, BASHM, FRAN, LAZI, GANHE, LAZI, BRCK, LAZI, MARI, LAZI, DEDA, LAZI, ROBERT, LAZI, IMRITIN, LAZI, ROE, PERAN, MEDIN, BEGO, MURIZO, BEGO, INCI, BEGO, SAM, KAGA, MUKADES, ELED, FIDMET, KISA, HADISE, ZIBA, HOKETE, ZIBA, HALL, LAZI, APERDITA, LAZI, ENVAL, LAZI, SENDA, LAZI, DHAMTER, BOLLO, LILIANA, BOLLO, KOSTANDIN, BOLLO, VIKILAQ, BOLLO, PAL, STELA, PIETER, STELA, LLESH, NEGOMANGI, KEMTO, NEGOMANGI, AQIM, KODRA, KADRI, KODRA, QAZIM, FERRA, VENAMIN, FERRA, MURANA, MALINA, HANI, FERRA, ZIBET, NOKA, RLBHUE, NOKA, HALL, NOKA, NEVRL, NOKA, PELLUMB, NOKA, CHURATA, MALIA, FERRA, MINDI, STARO, LACOMI, BROHIDA, GINI, VIOLETA, GINI, HWI, HERR, ZHRIE, HDRI, FREDERIK, HDRI, JAVERS, HDRI, GEMRHN, HDRI, IETIT, HDRI, AGRON, HDRI, PELLUMB, HDRI, MIRETA, HDRI, RIZA, HDRI, EDHRA, HDRI, ANI, ISMAILI, HEM, ISMAILI, DALE, ISMAILI, LIBE, MNE, XHEK, ZIM, XHEML, IMFARQO, PELLUMB, IMFARQO, ILIR, GENTI, IMFARQO, IMFARQO, FLORENÇ, RZM, SERIE, RZM, ARVAN, RZM, SONLI, RZM

Azilant në Hungari, kërkohet t'i hiqet mandati i deputetit, ish-kryeministrit maqedonas

# Gruevski në arrati, reagon Zaev: S'kam komunikuar me të

## Rasti "Tank", ish-kreu i Maqedonisë dënohet me 2 vite burg

Kuvendi të Maqedonisë i janë parashtruar pesë kërkesa për marrjen e imunitetit të deputetit Nikolla Gruevski, i cili tashmë ka fituar azil politik në Hungari. Mediat maqedonase raportojnë se kërkesat në fjalë do të shqyrtohen në seancën e sotme të Komisionit për Çështje të Rregullores dhe Mandatit të Imunitetit, me të cilin kryeson Pavle Bogoevski nga Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë. Gruevski u dënua me dy vite burg për rastin "Tank", për blerjen e një mercedesi luksoz. Gruevski akuzohet edhe në lëndët gjyqësore "Trajektorja", "TNT", "Titanik" dhe "Dhuna në Qendër", të gjitha këto, gjithashtu, raste të PSP-së, për të cilat do të gjykohej në mungesë. Përveç kësaj, Gruevski është i dyshuar edhe në disa hetime të hapura të PSP-së, midis të cilave "Talir", "Propaganda", "Harmonia". Ndërkaq kryeministri Zoran Zaev mohan kontaktin me ish-kryeministrin në arrati Nikolla Gruevski, para se ky i fundit të largohej nga Maqedonia drejt Hungarisë. Zaev thotë se nëse do të ndodhte një bisedë e tillë mes tyre, kjo me automatikisht do të konsiderohej si i njëjti me marrëveshje. Me Gruevskin prej kur jam kryeministër, nuk kam kurrfarë kontakti. Kontaktet e fundit ishin kur Kuvendi ishte robëruar, bllokuar në atë diskutimin e pafund para se të ndodhnin ngjarjet e



Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev

padëshirueshme më 27 prill. Ajo ndodhi aty, në Kuvend, kur biseduam ta zhbllokoni procesin, se ishte e qartë që ekzistonte shumica dhe të mos e keqtrajtonim Maqedoninë dhe institucionet e Maqedonisë. Atëherë, ndodhën bisedat e fundit", tha Zoran Zaev, kryeministër i Maqedonisë. Zaev tha se prokuroria dhe Ministria e

Brendshme bëjnë hetime serioze rreth arratisjes së Gruevskit në Hungari. Zaev shton se situata e re e krijuar dhe paraburgimi i funksionarëve të VMRO DPMNE-së, Janakieski, Bozhinovski dhe Mijallkov nuk do ta vendosë në pikëpyetje mbështetjen që të dytë deputetët e kësaj partie i dhanë ndryshimeve kushtetuese për zbatimin e

Marrëveshjes së Prespës. Më vjen keq që deputetët thonë se kjo ndikon. Gjithsesi unë shpresoj se do të mbeten në qëndrimet e tyre, sepse procesi si rrjedh diskutimi për draft-amendamentet e Kushtetutës, do të përfundojë debati publik pas seancës së dytë plenare që është e planifikuar për në 1 dhjetor dhe të kumtojme amen-

### ZORAN ZAEV

"Me Gruevskin prej kur jam kryeministër, nuk kam kurrfarë kontakti. Kontaktet e fundit ishin kur Kuvendi ishte robëruar, bllokuar në atë diskutimin e pafund para se të ndodhnin ngjarjet e padëshirueshme më 27 prill. Ajo ndodhi aty, në Kuvend, kur biseduam ta zhbllokoni procesin, se ishte e qartë që ekzistonte shumica dhe të mos e keqtrajtonim Maqedoninë dhe institucionet e Maqedonisë. Atëherë ndodhën bisedat e fundit", - tha Zoran Zaev.

damente me të cilat do të vërtetojmë përfshirjen serioze të diskutimeve dhe propozimeve të opozitës në vetë amendamentet kushtetuese, që sipas meje do të thotë konfirmim të shumicës prej 2/3, madje edhe rritjen e së njëjtës. Por kjo është vetëm shpresa ime"- u shpreh Zoran Zaev. Ai tha se vijon faza e fundit e ndryshimeve kushtetuese.

### SHKURT

#### Scott: Tarifat doganore të Kosovës ndaj

#### Serbisë, diskriminuese

Ndër të parët që reagoi pas vendimit për heqjen e tarifave doganore mes Shqipërisë dhe Kosovës ishte ambasadori amerikan në Beograd Kajll Skot. Heqjen e tatimit për Shqipërinë dhe shtimin e taksave për Serbinë, Skot i konsideroi si vendime diskriminuese. Kyle Scott, ambasador i SHBA në Beograd: Kosova është një shtet i vetëm dhe vendosja e një tarife diskriminuese në njërin anë të vendit kundër pjesës tjetër të vendit është një propozim tepër i pazakontë. Sipas ambasadorit, Kosova duhet të jetë shtet multi-etnik dhe qeveria kosovare duhet t'i marrë vendimet mbi këtë parim. Kyle Scott, ambasador i SHBA në Beograd: Ajo është e mirë për qytetarët shqiptarë të Kosovës, duhet të jetë e mirë edhe për qytetarët serbë të Kosovës dhe etnitë e tjera. Përpuna mbledhjes së përbashkët mes të dy qeverive, presidenti serb Aleksandër Vuçiq e quajti hipokrizi heqjen e barrierave kufitare. Në kryetullin e të përditshmes serbe "Večernje Novosti", shkruhej se kjo mbledhje ve vulën krijimit të Shqipërisë së Madhe. Ndërsa e gazeta tjetër "Politika" e quajti "Provokim të ri" foton e kryeministrit Rama me ministrin kosovar të tregtisë Endrit Shala me diciturën 100%.

#### SHBA hapin sërish pikën kufitare me Meksikën

Shtetet e Bashkuara kanë rihapur pikën kryesore kufitare me Meksikën, pasi fillimisht ishte mbyllur për disa orë, meqë zyrtarët amerikanë kanë përdorur gaz lotsjellës për të larguar protestuesit që kanë tentuar të kalojnë përtej zonës që ndan dy shtetet. Zona kufitare në San Ysidro që ndan San Diegon me Tijuaniën ishte mbyllur në të dyja anët më 25 nëntor; ka njëfuqitur Agjencia amerikane për Mbrojtje të Kufirit dhe Doganave. Meksika ka thënë se do të dëbojë migrantët që, siç ka thënë ten-tojnë të kalojnë "dhunshëm" dhe "ilegalisht" kufirin me Shtetet e Bashkuara. Tensionet në këtë zonë kufitare janë rritur për javë të tera pasi karvani me mijëra migrantë nga Amerika Qendrore i është afur kufirit të SHBA-së. Prej kur kanë arritur afër kufirit migrantët kanë qëndruar në një stadium të futbollit në Tijuana teksa kanë pritur që të nisnin kërkesat për azil. Rregullat e reja kanë prekur më së shumti migrantët nga Amerika Qendrore duke përmendur Guatemalën, Hondurasin dhe El Salvadorin, të cilët janë nisur drejt SHBA-së, për t'i ikur dhunës dhe varfërisë në shtetet e tyre.

### Tentuan ta kapnin në shtëpi, serbi reagon ndaj policisë kosovare

## Atentati ndaj Ivanoviç, Radoiçiq: S'isha shoku i ngushtë, por s'kam lidhje me ekzekutimin

Pas arrestimeve të fundit të disa personave në lidhje me vrasjen e politikantit serb në Kosovë, njëri prej tyre i shpallur në kërkim ka thyer heshtjen duke sfiduar edhe autoritetet ligjzbatuese. Bëhet fjalë për numrin dy të Listës Serbe Milan Radoiçiq. Ai ka shkruar se njësitet speciale të policisë së Kosovës kërkuar "ta vrasin" të premtën në mëngjes gjatë operacionit për arrestimin e katër personave, të dyshuar si autorë të ekzekutimit mafioz. "Nuk kam qenë shoku më i afërt i Ivanoviçit, por nuk jam vrasës dhe nuk kam asnjë lidhje me



Numri dy i Listës Serbe, Milan Radoiçiq

vrasjen e tij", ka shkruar ai. Nënkyetari i Listës Serbe e ka quajtur "kriminal"

aksionin e policisë së Kosovës, ndërsa thekson se është përdorur forca edhe

pse serbët po mbrojnë dinjitetin e tyre. "Aksioni i fundit kriminal i policisë

### MILAN RADOIÇIQ

"Erdhën tek unë në banesë ku jetoj me gruan dhe fëmijët, të armatosur deri në dhëmbë, me të vetmin qëllim që të më vrasin. Dhe për këtë kam dëshmi të qarta", thekson më tej nënkryetari i Listës Serbe, Radoiçiq.

dhe i pjesëtarëve të sigurimit privat famëkeq të terroristëve shqiptarë në Mitrovicë të Veriut ishte demonstrim i forcës ndaj çdo serbi që ka vendosur ta mbrojë dinjitetin dhe të drejtën e vet për jetë", shtoi ai. Ai tregoi se policia i ka shkruar në banesën ku jeton bashkë me gruan dhe fëmijët. "Erdhën tek unë në banesë ku jetoj me gruan dhe fëmijët, të armatosur deri në dhëmbë, me të vetmin qëllim, që të më vrasin. Dhe për këtë kam dëshmi të qarta", thekson më tej serbi. Gjithashtu, në fund ai ka deklaruar në formë të prerë se nuk ka ndër mend të dorëzohet, sepse nuk e lidh asgjë me vrasjen e politikantit serb.



BOTIMI

Ja një portë përballë "Shkollës së Kuqe". Është druri, ka çekiqin në formë dore, që shërben si zile, tre rreshta tjegulle kafeje mbi, ka avllitë të bardhë në dy anët e saj.

Ishte identik me portën e shtëpisë sime, nga e cila kemi ruajtur si relike vetëm çekiqin. Zhvillimi urban, evropianizimi, plani francez i qendrës, lëvizja e lirë, poliçendrat, projekt i danez apo austriak... janë konceptet që po vrasin kujtimet e mia. Sa pak që ka mbetur nga qyteti im". Kur Rezi Delisula shkruante këto radhë më shumë se një vit më parë, ende nuk e kish nisur punën për librin e saj më të ri "Tirana-Mahnia".

"Nga pikëpamja arkitektonike dyqanet e pazarit të vjetër pjesën balllore e kishin më të dukshme, ndërsa pas kishin vendin për fjetje, ku bënin roje beqarët. Kjo pohohet edhe nga prof. Emin Riza në studimin "Qyteti dhe banesa shqiptare e mesjetës së vonë". Dyqanet mbylleshin me dy dërrasa të mëdha si kapakë, që më pas u zëvendësuan nga "tarabat", që më vonë krijuan "tartabenat", mindere të lartë gjysmë metri që nxirrshin në rrugë deri në një metër e gjysmë jashtë dyqanit. Ky sistem i tartabenave bllokoi kalimin në rrugë, por rriti komunikimin mes dyqanxhinjve e sipas të vjetërve, tregtarët edhe urimet e ngushëllimet i prisnin në dyqan".

Gazetarja Rezarta Delisula, kësaj radhe si studiuese e veshur modestisht me "titullin tironese e vjetër", na fton të shohim kryeqytetin me sytë e saj për të shfletuar "Tirana-Mahnia" që rreket të shpjegojë pyetje si të mëposhtmet: Si ka qenë Tirana në vite? Si është transformuar sot? Si kanë qenë sheshet (me foto) që janë shndërruar disa herë në këto dekada? Cilët janë personazhet që i kanë dhënë shumë Tiranës? Si mund ta prezantojmë kryeqytetin jo vetëm për brezat e rinj (qofshin vendas apo komunitet që i është bashkuar së fundi ritmit të jetës kryeqytetase), por edhe për të huajt, sepse libri vjen në shqip e në anglisht. E në fund si mund të gjejmë një arsye të mirë për t'u takuar dhe për të pirë një gotë vere bashkë Tirana-mahnia: një guidë historike, arkitektonike, zakonore e turistike për qytetin. Botimi i Delisulës, ka 5 pjesë. Nis nga vështrimi historik, Tirana si ishte e si është me fotografi, shkrieme mbi kryeqytetin dhe personazhe, kryetarët e bashkive dhe çfarë të shihni në Tiranë. Botimi është shqip-anglisht më shumë për fëmijët e emigrantëve. Jo për tiranasit autoktonë, por për çdo njeri që lind e rritet këtu.

Pak por e sigurt është që ky libër ka çmëson, edhe nëse jeni vetë tiranas i vjetër nga ata që njohin çdo rrugicë, edhe nëse je nga ata që



# "TIRANA-MAHNIA"

## Si ka qenë Tirana dhe si është transformuar

Libri i gazetares Rezarta Delisula, një guidë dygjuhëshe për kryeqytetin



Rezarta Delisula

i është bashkuar dekadat e fundit Tiranës, por, edhe nëse je nga ata që di fare pak nga historia jonë, dhe të duhet një përmbledhje në anglisht për të marrë shpejt e shpejt shijen e një qyteti që ka histori të bukur, njerëz të bukur dhe kryesorja njerëz që e duan shumë siç është Rezarta Delisula. Një dashuri që ajo e ka trashëguar nga familja brez pas brezi dhe po kontribuon që kjo trashëgimi të mos mbetet vetëm të bisedat brenda shtëpije (që nuk janë më me qerpiç), por e kanë historinë të shkruar me "Tirana Mahnia" e nuk kanë më nevojë për tullat e baltës të thara në diell që të kenë çtë të tregojnë.

Gjatë karrierës si gazetare,



Delisula është marrë gjatë me kujtesën e qytetit, duke shkruar për mehanet që menaxhoeshin nga esnafët vllahë ditët e pazarit, të enjteve e të dielave, që mbusheshin plot; për ditët kur kamerierët ua çonin kafetë pronarëve nëpër dyqane. Referuar Osman Myderizit, në shekullin XVIII Tirana numëronte rreth 500 fillime dhe 150-200 dyqane ndërsa në fillim të shekullit kishte pasur 1000 shtëpi dhe 727 dyqane.

Delisula kërkonte ende "shpiti, gjysmë tullë e gjysmë qerpiç, me mure të trashë e shtruar me dërrasa si në tavan e në dysheme, me ato dritare të mëdha e plot dritë. Me ato avllitë e lyera me të bardhë dhe sipër tyre xhama të thyer për të siguruar mbrojtjen nga keqdashësit. Ndonjë

"Nga pikëpamja arkitektonike dyqanet e pazarit të vjetër pjesën balllore e kishin më të dukshme, ndërsa pas kishin vendin për fjetje, ku bënin roje beqarët. Kjo pohohet edhe nga prof. Emin Riza në studimin "Qyteti dhe banesa shqiptare e mesjetës së vonë"

me pus, e një tjetër me magjen në fund të oborrit, me kallërrme që shkëlqenin si pasqyrë... Lagje të tëra, fundosur në themelet e gjigantëve shumëkatesh. Nuk ka më asnjë vend ku unë të tregoj Tironën time, asnjë vend". Ajo kujton se në vend që të thuash takohemi te Kursali, themi: shihemi te autobusët e Kamzës. Nuk thuhet më; te shpia e Cenit të Lakut (mjekut ortoped të 500 mijë pacientëve), por te paidhaqet e Dajkos... Për ditë, ngulet ndonjë lopatë e re, duke zhdukur si me mllaf çdo gjë që ka mbetur nga e shkuara.



KRITIKA

# Liria e shkrimit të "Saga e vogël" e Besnik Mustafajt

Nga Dr. Blerina Suta

Shkrimi i veprës "Saga e vogël" (1995) ka përshkruar në tri kohët e krijimit të historive të veçanta, fazën kalimtare të rënies së regjimit komunist në Shqipëri. Elementi paratekstual i titullit, "Një sagë e vogël" përmbys modelin e drejtpërdrejtë dhe të zhurmshëm të letërsisë soc-realiste i ngjashëm me "sagën e madhe", duke paralajmëruar se raportit të shkrimit me lirinë (temë që sendërton edhe veprat e tjera të së njëjtës fazë ("Vera pa kthim dhe Gjinkallat e vapës") nuk mund të diktohet nga modelin kolektiv i heroit, trashëgim i modelit kulturor të këngës epike. Karakteri i dyfishtë i historive private të romanit si histori qëndresash dhe shpresash të mëdha, përmbys modelin mbisundues të shkrimit dhe të kulturës publike gjatë epokës së komunizmit, ndëruar mbi heroin tipik përfaqësues i klasës kolektive. Protagonisti i historisë qëndrore, Bardhyl Huta, e kërkon pjesëmarrjen e lexuesit në senditimin e poetikës së veprës, kur zhvesh para tij mekanizmin e saj narrativ dhe deklarohet në rolin e dyfishtë prej naratorit dhe personazhit të historisë. Historia e Bardhytit është njëkohësisht histori e familjes së tij, fati i së cilës është shënuar në mënyrë fatale prej idesë së burgimit politik. Pjesa e parë i kushtohet të atit të Bardhytit, Omer Hutës, që nuk e kishte njohur të atin, i burgosur politik, përveçse nëpërmjet këngës heroike që e përshkruan si kreshnik. Takimi i parë në burg mes të dyve trand thellësisht të birin, i cili, në përballje me imazhin e vuajtur dhe të mpakur që i del përpara, pëson shkërmoqjen e modelit prindëror. Jeta e tij prej të rriturit, si prind i Bardhytit, përshkruhet si një hije, paranezë tërësisht e kushtëzuar nga frika e burgut politik.

Në pjesën e dytë protagonistin Bardhyl, dhe ai i burgosur politik, për kompromiset që pati bërë me rregullat e burgut, fiton si shpërblim një natë takimi me gruan e tij Linda. Historia zhvillohet në dhomën e takimeve familjare në burg, me Bardhylin, i cili, për të idesë obsessive se në anën tjetër të murit, në dhomën ngjitur dikush po përgjon dhe po regjistron natën e tyre të dashurisë për ta përdorur më pas, e mbyll natën pa folur dhe pa bërë dashuri. Pjesa e tretë përshkruan historinë e vetëmblyljes në burg të Hyqmetit, gyshtit të Lindës, rrefyer sipas shënimeve të gazetarit të kronikës i cili donte të bënte me të një roman. Hyqmeti e vret gazetarin dhe bashkë me të edhe të birin e kasapit të qytetit që kishte abuzuar me të bijën. Por dhe Hyqmeti vritet në atë rast nga zyrtari ushtarak i qytetit, prandaj dhe historia e asaj që në qytet konsiderohej çmendje e



## Kur vritet modeli mashkullor i heroit socialist, që letërsia zyrtare imponon

Hyqmetit, i vjen lexuesit prej varianteve të thashethemeve të rrefyera dhe të shpërndara në berberhanen e qytetit. Historia e të burgosurve politikë përfaqëson vetëm pjesën më ekstreme të dhunës që pëson individin dhe tërë shoqëria nën diktaturë. Harku i gjatë kohor që përfshijnë ngjarjet e romanit nga mbretëria, tek lufta dhe më pas komunizmi, qëmon tiparet karakterizuese të morfologjisë së diktaturës të ndërruara nga një perspektivë e dyfishtë ku domethëniet "brenda" dhe "jashtë" që karakterizojnë burgun ndërkëmben.

Figura kyçe që bart tensionin artistik të veprës është ajo e murit, që në përshkrimin e asaj çka është brenda dhe jashtë tij, përmbys modelin e raportit shkrim - publik, në emër të idesë së "murit që mbron" përkundrejt "murit që burgos", duke e ftuar lexuesin në një proces të huajtësues transformimi. Kjo ide propozohet qysh në hyrje të veprës nëpërmjet leximit të përmbysur të mitit të Odisesë si rrefim drejtuar pasardhësve të cilëve do "t'u tregoj si e dogjën trojanët kalin e drunjtë të grekëve/ pa e lënë t'u shkëlë në qytet".

Dy historitë njerëzore të Bardhytit dhe Hyqmetit, përplotësuere dhe pasqyrë e njëra tjetër në raport me burgun politik, me gjithë rolet simbolikisht të kundërta prej viktime dhe xhelati, janë, në fakt, dy histori të vogla heroizmi të madh dhe dashurie për lirinë, në kushtet e humbjes së saj me të skajshme. Historia e Bardhytit, në absurdin e procesit të tëhuajtësimit, ndërsa ndërton hijen e "vetvetes tjetër", si mjet mbrojtjeje nga "veshi" mekanik i Shtetit, vë në skenë një rrugëtim

njoheje, thellësisht të kthjellët të mekanizmit funksionues të kodit të diktaturës. Figura e "gozhdës" në turin e tij, pra obsesioni i përgjimit, bëhet embleme e epërsisë së njeriut ndaj asaj hijeje totale, që fshehur në anën tjetër të murit, ruan dinakërisht brenda kutjes së së makinës intimitetit, duke e përbaltur atë, duke e bërë pis. Historia e tij shënon një fitore kundër dhunës që shteti injekton në lojën e tij të përhershme të përkuljes së individit. Muri alegorik i rojes Hyqmet, vetëmblyllur në burgun e zbrazur prej të burgosurve në prag lufte rrezaton vlerën emblematike të "mbyljes" për të qenë "jashtë" botës së qytetit, asaj bote që nuk vonon të shpalojë dhunën e shumicës mbi individin. Në shumë vite shërbim në burg historitë e të burgosurve politikë bëhen gurë të rëndë që fortifikojnë kështjellën e dinjitetit njerë-

zor të Hyqmetit që nuk e pranon nënshtrimin. Lexuesi ndjek mvshjen e dalëngadalit të vështrimit të tij nga hije dhe gjelbër e hakmarrjes si akt drejtësie për nderin e lënduar të së bijës por dhe si simbol i mostjetërsimit të njerëzores.

Imazh të përmbysur përkundrejt këtyre dy historive shprese e ndërton historia e Omerit, atit të Bardhytit, embleme e përmasës të së tmerrshmes që gjendet jashtë mureve të burgut politik. Omeri ngelet përgjithnjë i mbyllur jashtë jetës, në të dyja fazat e zhvillimit të saj: në fëmijëri, i "mbështjellë muaj pas muaji si një hije" me lavdinë e të atit, i burgosur dhe viktimë e modelit të zbrazët epik të jetës sipas të cilit jeta është veç një parantezë në pritje "me e b? deken si me le"; në moshë të rritur; i burgosur dhe viktimë e ndjenjës së frikës që Shteti instaloj në brishtësinë dhe zbrazëtinë e tij të brendshme, duke e transformuar funksionin e tij si prind në jetën e Bardhytit në një hije të vërtetë. Kodi shprehës i gjuhës zyrtare mishëron mekanizmin e dhunës dhe nënshtrimit të individit. Në shoqërinë shqiptare diktatura përvetësoi në "morfologjinë e gjuhës së saj" kodin epik të lavdisë heroike të së shkuarës. Operacioni i rrezikshëm mbi gjuhën ishte kryer duke u bazuar në pushtetin që kishte mbi individin modeli kulturor "nër vs. turp" për ta përkthyer në një praktikë të pushtetit të kolektivit mbi jetën e individit. Procesi karnevalesk i lindjes së "varianteve" të historisë së Hyqmetit në qytet, që luhaten mes heroizmit shterp dhe çmendurisë, zhvesh, në fakt, mekanizmin e mneshmë të ndërimit të turpit si proces rrethimi dhe gjykimi që shumica ushtron mbi "të ndryshmin" mbi atë që mundahej t'i qëndronte forcës rrafshuese të ideologjisë së shtetit.

Lindur nga dhe për llitari të kolektivit, kjo punishte thashethemes funksionon në stil epik, me variante që ndjekin njëra-tjetër, në shërbim të invariancës zyrtar, atij të prodhuar nga 'punishtja' e artit soc-realist, përfaqësuar nga figura e gazetarit të kronikës Andi Bodeci.

Shkrimtar tipik në shërbim të shtetit, përpjekja e tij për t'ia nënshtruar variantet e rrefyera një ideali kolektiv kallp të heroit është përpjekje për institucionalizim të individit njëpërmasor karikaturë e modelit të kreshnikëve në këngët shqiptare.

Përkrimi që ai i bën Hyqmetit si një farë Gjergj Elez Alije i kohëve moderne, të pajisur me veshje metalike, gati për luftë, le jashtë përshkrimit, duke e izoluar brenda, botën e brendshme të personazhit. Profili i Hyqmetit në projektin romanor të Bodecit, shndërrohet në një embleme të shkrimit të partisë, tërësisht të kalibruar mbi simbollogjinë e jashtme, tipike e shkrimeve superstrukturore të ideologjisë së kontrollit.

Romani bart dy histori intime, histori dashurie: të një burri prej gruan e tij dhe të një atit për të bijën. Me vrasjen e Bodecit prej Hyqmetit vritet dhe modeli mashkullor i heroit socialist që letërsia zyrtare imponon sipas modelit të trashëguar heroik të së shkuarës.

Mustafaji tërhiqet prej modeleve femërore baladeske të traditës gojore: prej lotëve të motrës, burim i forcës mbijnëzore të Gjergj Elez Alisë; prej flajëve dhe lotëve të zonjës mëmë, burim i forcës së Kostandinit që tejkalon dhe varrin; prej nuses së re të murosur që flijohet për t'i lejuar vëllezërvë Roza dhe Fa ndërtimein e kështjellës. Jo rastësisht në hapësirë e izoluar onirike të rrefimit, që brenda-qarkojnë ndjenjën e shkrimtarit, rrefimtarizoloni fragmente të ëndrës për një "qytet të njeriut" ku dashuria dhe intimiteti të mbrohen, ashtu si në ëndrën e Omerit të vogël që përgjatë udhëimit të tij për në burg ëndërrohet qytetin që nuk kish e parë kurrë, me muret e ndërtesave të lyera me qumësht. Injenti qumësht sipas baladës, lag edhe sot muret e kështjellës së Rozafës, embleme e dashurisë mëmërore dhe e shpëtim-it, në veprimin e një nëne të re që para murimit gjallë në kështjellë kërkon t'i libet e lire një dorë për të përkundur foshnjën që në gjoks për ta ushqyer. Shpëtimi njerëzor në stacionet e rrënimit të saj është femër, ruajtësja më e madhe e jetës kur njeriu, rastësisht pengohet dhe bëhet një guricë për t'u shkelmuar. Ky arsytim mbi historinë ndjek skenën fantastike të lindjes së një guri të rëndë nga ana e Lindës, në mbyllje të romanit, objektivizim i idesë shtesë të veprës, asaj të murit të lirisë që ndërtohet nga çdo gjetje i vogël që njeriu kryen në mbrojtje të dashurisë dhe intimitetit.



MONUMENTI

# Kisha e shek.XII, trashëgimia shqiptare në kalanë e Tivarit

Dom Nikë Ukgjini

Konservimi dhe restaurimi i çdo objekti të mesjetës apo të antikitetit na rikthen në kujtesë, kohën e lavdishme të popullit tonë dhe atë të trishtimit që ndodhën pas, nga pushtuesit më pikant të njëpasnjëshëm, si: bizantinët, sllavët e tjerë e nga shek. XV, osmanet të cilët këta të fundit ndërprejnë çdo fije të zhvillimit të vrullshëm në çdo drejtim të jetës sonë Arbërore. Si pasojë e këtyre ngjarjeve dhe atyre që pasuan pas vitit 1878 më Kongresin e Berlinit kur trojet tona iu shpërndanë fqinjëve, kthimi në identitet i çdo objekti të mesjetës jashtë kufijve administrativë të Shqipërisë, mallëngjëjnë pa masë. Të përfshirë me këto emocione, një grup intelektualësh nga Shkodra më 25 nëntor, morën pjesë në ceremoninë kishtar më rastin e bekimit të Kishës së Shën Katarinës të posa restauruar nga Tivarin e Vjetër, organizuar nga Kryeipeshkvi i Tivarit Mons. Rrok Gjonllëshaj. Në fjalën e rastit e mbajtur, duke përsëritur edhe në gjuhën shqipe, ai shprehu gëzimin dhe falënderimin për Ministrinë e Kulturës dhe qendrës kulturore të Tivarit për këtë dhuratë të çmuar dhënë Kishës së Tivarit dhe kulturës. Gjonllëshaj u shpreh se, "Kisha e Shën Katarinës, na kujton edhe rrënojat të tjera dhe përgjegjësit që kemi për to. Por sidoqoftë na duhet t'i drejtojmë sytë drejt së ardhmes - sikur drejt qiellit nga ku do marrim shpërblimin tonë për veprat tona tokësore". I pranishëm, Nunci Apostolik Mons. Luigi Pezzuto, për Malin e Zi me seli në Sarajevë, tha se krishterimi në këto treva ishte para se të ndërtohej kjo kishë, në shek. XII-XIII. Morën pjesë edhe kryetari i Komunës së Tivarit, Dushan Raiçeviq, dhe zv. Kulturës, Aleksander Dajkoviç, të cilët Kishën e Shën Katarinës Monument Kulturë tani të restauruar e lanë në shërbim të besimtarëve të kësaj kryedioqeze, Pastaj morën pjesë ipeshkvi i Kotorrit, Imzot Ilia Janiq, Imzot Zef Gashi, meshtar si dhe besimtar të ardhur edhe nga Ulqini e Tuzi. Kisha e Shën Katarinës, e stilit romano-gotike, sipas studiuesve malazezë, është një ndër katër kishat e mbetura nga pushtimet osmane. E ndërtuar në shek. XIV, në themelet e një kishë tjetër më të zgjeruar të shek. XII, nga gjurmimet arkeologjike të kryera gjatë restaurimit, pos elementeve të rëndësishme ilire, njëherazi është zbuluar së Kisha e Shën Katarinës, objekt i lidhur ngushtë me kishat e tjera në formën e një manastiri të urdhrave kishtarë. Nga shtrirja gjeografike



Objekti i mesjetës kthehet në identitet

kuptohet së në afërsi të saj ka pasur, Kishën e Shën Nikollit e Shën Prendës dhe në distancë jo fortë të lart Katedralen e Shën Gjergjit, të cilën Turqit me rastin e pushtimit të Tivarit në vitin 1571, e patën shndërruar në xhami. Sipas raportit të Selisë së Shenjte, Marin Bicit të vitit 1610, rreth e përqark kalasë e ndërtuar nga romaket dhe rindërtuar nga bizantinë në shek. IX, ka pasur edhe dhjetëra kisha të tjera të cilat turqit i shkatërru-

an dhe i tjetërsuan për nevojat e tyre ushtarake. Sipas, Ivan Markoviç, para pushtimit osman në Tivar flitej, gjuha zyrtare latinishtja e italishtja e në popull shqipja dhe ajo sllave. Sipas Bicit në shek. XVI, shënohet ardhja masive e serbëve dhe malazezve nga malet duke ndryshuar strukturën e popullatës së këtij qyteti, të cilët deri atëherë ishin të gjithë katolikë. Se lidhja e shqiptarëve me këtë treva ka qenë evidente na dëshmon

edhe kryeipeshkvi i Tivarit, Guillmo Adae, (1324-1341), i cili në vitin 1332 duke shkruar për evazonien serbe në këtë zonë, ka shkruar se shqiptarët janë katolikë dhe kanë gjuhën e vet dhe librat e veta. Prezencën e shqiptarëve na tregon dhe fakti se don Gjon Buzuku, për shkak të nevojës të besimtarëve të kësaj kryedioqeze, shkroi dhe Mesharin e tij në vitin 1555. Nga ana tjetër, në Selinë e kësaj kryedioqeze e cila ishte pararoje katolicizmit dhe shqiptarizmit në këtë pjesë të Ballkanit, gjatë pushtimeve osmane dhe trazirave të Kishës serbe ortodokse, në krye të kësaj serie kanë qëndruar heroikisht, Gjon Bruno Harapi, Pjeter Mazreku, Gjergj Bardhi, Pjeter Bogdani, Mark Jorga, Lazer Vlladani, Gjergj Junku etj. Krahas kontributit të këtyre kolosëve, duke filluar nga shek. XI, besimi katolik është dëshmuar dhe është ruajtur, në fakt, me firo të ndjeshme, deri në ditët tona. Duke sositur kalanë e Tivarit dhe objektet të tjera trashëgimisë kulturore, kuptohet se historia kishtarë ndërthur me historinë e tjerë: me historinë politike, ekonomike, sociale, kulturore duke na dhënë një rrëfim me shumë pamje, ku secila ndihmon të kuptohet tjera dhe të gjitha së bashku formojnë një të tërë. Gërmdhat kulturore flasin për marrëdhëniet e Kishës katolike shqiptare me "të tjerët", në etni ose

## "ANNE DHE ZEF", NJË OPERA PËR DY FËMIJË



Opera 'Anne & Zef', e përkthyer në anglisht tregon historinë e Anne Frank që takon djalin 15-vjeçar shqiptar Zef Bunga në qiell. Kur Zefi flet për kanunin, gjakmarrjen dhe vëllain e tij, Anne flet për kohën e saj në kampin Westerbork dhe kampin e përqendrimit Auschwitz. Ata ankohen për prindërit e tyre dhe ndajnë ëndrrat. Kjo bëhet baza për një lidhje shumë të veçantë mes dy adoleshentëve. Anne Frank vdiq në kampin e përqendrimit Bergen-Belsen. Zef, një djalë shqiptar i ditëve tona, është viktimë e një hakmarrjeje. Ata takohen me njëri-tjetrin në parajsë ku zbulojnë se kanë shumë gjëra të përbashkëta me njëri-tjetrin, pavarësisht dallimeve kulturore. Anne është shkrimtare, Zefit i pëlqen të jetë aktor dhe të dy kanë probleme me prindërit e tyre. Pjesa e Anës luhet nga sopranoja shqiptare Anjeza Marku (2002), ndërsa baritoni Patrik Vjollca

nën drejtimin e Huba Hölloköi-t. Libretisti Ad de Bont shkroi libretin për përshatjen e veprës së tij të suksesshme Anne & Zef, e cila bazohet në ditarin e njohur me famë botërore të Anne Frankut. Muzika është krijuar nga Monique Kris. Regjisorja e operës, Corina van Eijk bën të ditur: "Të dy fëmijët kanë jetuar të izoluar deri në vdekjen e tyre, megjithatë ata takohen me njëri-tjetrin në kontekstin e lirisë absolute; në jetën e përtëjme. Me këtë opera, duam të tregojmë se shumë pak ka ndryshuar nga koha e Anne Frankut. Njerëzit janë ende të izoluar në vende për të cilat nuk dinë asgjë. Këta njerëz nuk shfaqen në lajme, megjithatë, historitë e tyre dalin në pah pas shumë kohësh pasi ato kanë ndodhur. Falë Anne Frankut, ne tani dimë shumë më tepër për jetën e përditshme gjatë Luftës së Dytë Botërore. Kjo nuk është një temë e thjeshtë, megjithatë, për shkak të muzikës prekeze, e cila

është kompozuar posaçërisht për këta këngëtarë të rinj, opera premtom të jetë një pjesë emocionuese dhe tepër prekeze. Opera është e përshatshme për të rritur dhe fëmijë nga mosha 12 vjeçarë. "Anne & Zef" është autorizuar nga Orkestra Filarmonike Holandeze. Produksioni original i orkestrës në dirigjimin e Corina van Eijk, me skenografi dhe video të animuara nga Jolanda Lanslots dhe ndriçim nga Henk Post do të prezantohet me një përkthim të ri në gjuhën angleze nga Jonathan Levi në bashkëpunim me Opera Spanga, Syrinx Blu, ambasadat e Mbretërisë së Vendeve të Ulëtës së Tiranës dhe Prishtinës, të mbështetur nga Bavaria Holland, VidiSquare, Neelevat, Fiege transport, "Fondi për Performancën e Arteve të Hollandës" dhe Ambasada e Izraelit në Tiranë.

**KU DHE KUR?**

- 5 dhjetor | 16:30 | Tiranë, Universiteti i Arteve
- 6 dhjetor | 18:00 | Kamzë, Pallati i Kulturës
- 8 dhjetor | 18:00 | Gjakovë Shkolla "Prek Jakova"
- 9 dhjetor | 20:00 | Prishtinë Kino "Armata"

(1997) do të jetë në rolin e Zefit. Muzika do të luhet nga orkestra e përbërë nga muzikantë shqiptarë

Opinion i Ditës

# Për gjeneralë të paqes dhe ministrin Lleshaj

Nga Jorgji Kote

(vijon nga faqja 1)


... dhe ushtarakët e lartë; duke i parë ata kryesisht si njerëz që dinë vetëm të ndeshen, të luftojnë dhe të asgjësojnë në front, me muskuj, shpata dhe topa; shkurt, si komandantë dhe drejtues të përshtatshëm për luftë dhe aq. Mirëpo, përvoja ndërkombëtare dhe në mënyrë më modeste e vendit tonë sjellin jo pak shembuj të spikatur mbi rolin e tyre po aq vendimtar dhe në procesin e paqëbërjes, rendit publik, diplomacisë, sigurisë, drejtësisë, etj.

Këtë temë " tejet në modë" në ditët tona e kam trajtuar mbi katër vite më parë në librin "Diplomacia për të gjithë (2014) në kreun mbi " fuqinë e butë dhe të ngurtë" (soft & hard power). Aty ka referime dhe për zotin Sandër Lleshaj, me të cilin në vitet 2003-2006 kam punuar në ambasadën tonë në Berlin; ndaj, po e riprodhoj këtu me ndonjë shkurtim të vogël.

"Ka pasur shumë komandantë dhe gjeneralë të shquar, që ashtu si në drejtimin e operacioneve gjigande ushtarake u dalluan dhe në realizimin e proceseve paqësore të qëndrueshme. Këta gjeneralë, ndoshta më mirë se të tjerët, e kanë provuar për vite e dekada në supe përgjegjësinë e madhe në luftë, sidomos koston e saj të pallogaritshme njerëzore, materiale dhe financiare. Ndaj, në përfundim të një lufte, ata e kanë kuptuar se identiteti i paqes dhe epërsitë e saj janë të padiskutueshme. Kësisoj, ata i janë vënë me po atë pasion dhe dëshirë, projektimit dhe realizimit të një paqeje të vërtetë. Gjenerali i lavdishëm Dwight Eisenhower, pasi drejtoi ushtrinë amerikane në Luftën e Dytë Botërore, në vitet 1952-1961 u zgjodh për dy mandate rresht President i SHBA-së. Gjatë presidencës së vet, krahas fuqisë së ngurtë ushtarake që ai e njihje mirë u shqua dhe për zbatimin me po atë sukses të "Fuqisë së Butë" (soft power). Ndërsa, zëvendësi i tij gjatë Luftës së Dytë Botërore, gjenerali i shquar George Marshall, pas lufte u bë kryediplomat dhe në këtë cilësi, në vitin 1947 lançoj planin e famshëm të ndihmave për demokracitë perëndimore që mban emrin e tij. Për këtë u nderua me Çmimin "Nobel" të Paqes.

Gjeneralët e paqes nuk kanë munguar as në Lindjen e Mesme. Ish-kryeministri izraelit Yitzhak Rabin në vitin 1993 bëri Marrëveshjen e Paqes me Liderin palestinez Jaser Arafat, me ndërmjetësimin e ish-presidentit Bill Clinton; po ashtu gjenerali egjiptian Anvar El Sadat, më vonë president i Egjiptit, që disa vite më parë kishte mundur gjeneralët izraelitë, në vitin 1979 shkoi për vizitë miqësive në Tel Aviv, për paqe me atë vend.

Shembulli i tyre tregon se pavarësisht nga çmimi i lartë që paguan me jetën e tyre, nuk ka al-



ternativë më të mirë e më pak të kushtueshme se paqja, mirëkuptimi, toleranca dhe miqësia ndërmjet popujve, pavarësisht nga e kaluara e tyre.

Kombinimi i "Fuqia e butë"ngurtë" të çon në filozofinë e re moderne të "fuqisë së mençur ose inteligjente" (smart power) që lindi në vitet 80.

Në këtë drejtim po shquhet dhe NATO nëpërmjet konceptit të saj strategjik " mbrojtje inteligjente" (smart defence). Në prill 2013 isha i pranishëm në një takim mbresëlënës në Bruksel me komandantin e atëhershëm të NATO-s për Europën, admiralin amerikan, James G. Stavridis. Të gjithë prisnin që të fliste kryesisht për armët, tanket, anijet ushtarake, luftërat dhe strategjitë ushtarake. Por ai u ndal në më të shumtën e

kohës në "fuqinë e butë". Admirali nënvizoi se ndërsa shekulli i kaluar ishte epoka e ndarjeve, mureve, gardheve, bunkerëve dhe e izolimit, sot jemi në epokën e lidhjeve, urave, komunikimit dhe bashkëpunimit. Në këto kushte "fuqia e ngurtë" natyrisht do të përdoret në raste konfliktesh; por e vetme ajo është e pamjaftueshme, sidomos në rastet e paqëbërjes, demokracisë dhe begatisë ekonomike.

Për fat të mirë, edhe në vendin tonë kemi ushtarakë dhe gjeneralë që kanë bërë të tyret shumë elemente të "fuqisë së butë" duke krijuar kësisoj modele të vërteta dhe të "fuqisë inteligjente". Krahas talentit ushtarak, ata paraqesin kulturë, uredsi, tolerancë, dije dhe vlera qytetare. Natyrisht që kualifikimi dhe trajnimi në vendet perëndimore, si në SHBA, Gjer-

mani, Francë e gjetkë ka pasur ndikimin e tij madhor në këtë drejtim.

Duke u kufizuar në vitet e fundit, dua të përmend këtu gjeneralët e mirënjohur, Arjan Zaïmi, Vladimir Qirjazi dhe Sandër Lleshi. Dy të parët i njoh më tepër nga shkrimet kushtuar tyre dhe nëpërmjet konsideratave të miqve dhe të njohurve të mi që kanë punuar me ta; ndërsa me ish-gjeneral Sandër Lleshin jemi njohur gjatë punës në ambasadën tonë në Berlin, ku ai ishte atashu ynë ushtarak dhe më vonë në Tiranë.

Të them të drejtën këta njerëz që rrezatojnë mbi të gjitha qytetari dhe kulturë, më ndryshuan konceptin dhe imazhin që kisha për ushtarakun e ditëve tona, si njerëz të rreptë e të ashpër, që dinë të japin vetëm urdhra e të përdorin armë, të aftë për operacione dhe stërvitje ushtarake.

Por, duke ndenjur e punuar me Sandrin, duke marrë pjesë në vepërimtari të shumta diplomatike, kulturore, takime dhe me familjet tona, pashë se ashtu siç shkëlqen në drejtim të karrierës ushtarake, ai shquhet edhe në fushën e " fuqisë së butë".

Me po atë pasion që flet për artin ushtarak, armët dhe luftërat, Sandri flet e shkruan dhe për gjuhën shqipe, për artin, kulturën, librin etj. Reagoj menjëherë si qytetar dhe ushtarak pas një botimi kushtuar Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu; botoi me shpejtësi të rrafshme një libër me argumente dhe të shkruar me kulturë dhe u shfaq nëpër ekranet televizive, duke folur me kompetencë dhe

qetësinë e tij të rrallë.

Gjithashtu, Sandri dëgjon të tjerët me shumë vëmendje dhe interes dhe vlerëson përvojën e më të vjetërve. Ka një takt të spikatur njerëzor e diplomatik, modesti dhe përlulesi që buron dhe nga besimi i tij i sinqertë dhe i civilizuar katolik.

Fatkeqësisht, një ditë maji 2013 mësova mbi lirimin e tij të habitshëm "rrufe" dhe pa kurrfarë shpjegimi të vërtetë ligjor nga detyra e zëvendëshefit të Shtabit të Përgjithshëm, bashkë me dy gjeneralë të tjerë të nderuar.

Nuk dua të bëj komente, sepse është jashtë temës, por për shumë nga ne ajo ishte një ditë e keqe dhe e dhimbshme. Mendoni, kur shkarkohen këshu "me një të rënë të lapsit" tre gjeneralë të shquar e të ndershëm, pa iu referuar as dispozitave përkatëse ligjore, ç'mund të ndodhë me të tjerët!!!

Por, për fatin të mirë, më 23 gusht, Kryeministri Edi Rama njoftoi se Sandër Lleshaj do të ishte këshilltari i tij për sigurinë kombëtare. Po ashtu, ministrja e re e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, i emëroi sërisht disa gjeneralë të liruar në poste të larta të ushtrisë dhe mbrojtjes, duke e shpëtuar hierarkinë e administratës sonë ushtarake nga një poshtërim i vërtetë.

Më bëri përshtypje se në deklarimin e tij të parë publik pas këtij emërimi, Sandri e sintetizoi shumë thjesht e qartë konceptin "fuqia inteligjente" kur tha se "sot mbrojtja nuk është më çështje muskujsh, por mendje dhe intelekti, pra "mbrojtje inteligjente". Mbyllje më kuptimplotë për këtë kapitull nuk mund të kishte."

Opinion i Ditës

# Ari i zi në Francë dhe në Shqipëri

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... (40 lekë të vjetra) për litër më 1 janar 2019, me rritjen me 7.6 për qind të taksës për hidrokarbonin, si pjesë e fushatës së presidentit francez, Manuel Macron, për makina më të pastra dhe më shumë investime publike në energjinë e rinovueshme. Kaq mjaftoi që për dy javë protestat e qytetarëve të mos pushojnë. Të shtunën ishin 280 mijë qytetarë në rrugët e Francës. Vetëm 30 mijë në Paris, duke shpërthyer edhe në Champs-Élysées, pjesën më pulsante dhe të rëndësishme të kryeqytetit francez. Kanë kërkuar edhe dorëheqjen e presidentit të vendit, vetëm pse guxoi t'ju hyjë në hisen e shpenzimeve të përditshme për karburant.

Nërkohë, francezëve u duhen vetëm 1.6 për qind e të ardhurave ditore të përballojnë karburantin ditor. Lind natyrshëm pyetja: Po tek ne? Në Shqipëri shitet karburanti më i shtrenjtë në Evropë, në raport me të ardhurat për banor. Ne na duhen 10.3 për qind të të ardhurave ditore për ta blerë naftën ose benzinën. Megjithatë, në këto 28 vite tranzicion, as kemi dalë ndonjëherë nga shtëpia të protestojmë përse është kaq i shtrenjtë ari i zi. Po ashtu si francezët, edhe ne importojmë pjesën më të madhe të karburantit, 90 për qind na vjen nga importi. Pesë vite më parë, në nëntor 2013, kur një fuçi naftë në tregjet ndërkombëtare shitej 69 dollarë, ose 31 për qind më pak se disa muaj më parë dhe konsumatorët francezë dhe kudo në Evropë dhe në botë përfituan nga ulja po me 30 për qind e çmimit në tregun e tyre me pakicë. Ne jo. Në tregun tonë nafta vjoi të shtej një litër naftë me 1 mijë e 800 lekë të vjetra, njësoj sikur çmimi në tregjet ndërkombëtare të ishte 98 dollarë për fuçi.

Vetëm dy muaj më vonë u ul me 5 për qind. Në të gjitha tregjet e Evropës dhe në përgjithësi të botës, çmimet e karburantit u ulën më shumë se 6 herë sa kjo ulja jonë! Po të kishte ndodhur e kundërta, pra rritja e çmimit të naftës, sikurse ka ndodhur jo rrallëherë në këta 28 vjet, brenda dy ditëve ajo do të pasqyrohej edhe tek ne, me një rritje edhe më të madhe nga



ajo ndërkombëtare. Po bëhen gati tri dekada që tek ne ndodh një vjedhje e madhe, e pacipë, masive në kurriz të gjithë shtetasve tanë konsumatorë të karburanteve, që praktikisht janë 4 në çdo 5 familje tek ne. Çmimi i naftës tek ne ka qenë dhe vijon të jetë produkt i një marrëveshjeje të fshehtë (karteli) midis firmave oligopoliste (zotëruese të tregut) që kontrollojnë gjithçka.

Ato lehtësohen nga një kontroll sipërfaqësor i organizimave tanë fiskalë, si dhe shumë fije të qeverisjeve të djeshme e të sotme, të lidhura me interesat e bosëve të shumicës në tregtinë e karburantit. Karteli i naftës tek ne funksionon mrekullisht, pa pyetur për presion publik (presioni ose kontrolli qeveritar nuk duket gjëkund). Përveç që është më e shtrenjta, nafta tek ne ka edhe cilësinë më të dobët në rajon dhe ndoshta në të gjithë Europën. Kur vjen nga importi, nafta ka standardin evropi-

an. Përpara se sa të kalojë në pikat e pakicës ku tregtohet për të 566 mijë shoferët dhe pronarët shqiptarë të automjeteve, ajo përziehet. Jo vetëm me ujë, sikurse ndodh rëndom në pikat e pakicës. Në depot e shumicës ajo përziehet me elementë të demshëm, me naftë të papërpunuar ose të përpunuar keq shqiptare, me solar ose vajguri. Një naftë e tillë e papastër harxhohet shpejt, nuk lubrifikon mirë mjetin dhe nuk prodhon fuqi të mirë kalorifike. Megjithatë, ajo është më e preferuara për ata që e sjellin tek ne naftën nga importi. Kjo naftë e përzier rrit fitimet e kompanive që tregtojnë naftën me shumicë, por nga ana tjetër është një kosto si shëndetësore për qytetarët, ashtu edhe ekonomike.

Këta të fundit nuk mjafton që blejnë naftën më shtrenjtë se sa në vendet fqinje me fuqi të njëjtë ekonomike me tonën, por edhe u amortizohet makina më shpejt,

ose u dëmtohet ajo nga cilësia e keqe e karburantit. Kush do ta mbrojë konsumatorin, qytetarin shqiptar në këtë abuzim me produktin që ka një xhiro 670 milionë euro në vit tek ne? Shumë shpejt Kontrolli i Lartë i Shtetit do të bëjë publik një auditim të tij të performancës për cilësinë e naftës në Shqipëri. A do të jetë e aftë qeveria jonë të sulmojë interesat e abuzimit me naftën, që shkojnë mbi 100 milionë euro në vit, duke penalizuar të gjitha kompanitë që e përziejnë atë? Kush do ta vendosë qeverinë përpara përgjegjësisë, që kjo e fundit të vendosë përpara përgjegjësisë kompanitë që përziejnë naftën dhe mbajnë çmimin kaq të lartë? Francezët këtë punë po e bëjnë me protesta masive, edhe pse cenimi i interesave të tyre ekonomike është ku e ku më i paktë se vjedhja e konsumatorit dhe abuzimi me arin e zi në Shqipëri. Po ne, do të lëvizim gjë?

## HOROSKOPI

### DASHI

Sot do të ndiheni në tension për disa punë që i keni lënë pa përfunduar. Kuptoni se gjërat po lëvizin me shumë shpejtësi këto ditë ndaj ndiheni i papërgatitur veçanërisht për ndryshimet në jetën tuaj.

### DEMI

Mund të përballeni me shumë zhgënjime nëse përiçeni të luftoni rrethanat aktuale. Çështja kryesore është që çfarëdo situatë ku ndodhni ta shfrytëzoni për të mirën tuaj. Te qarat nuk ju zgjidhin problemet.

### BINJAKET

Mbajtja e gjërave në ekuilibër sot mund të jetë e ndërlikuar për ju. Ekziston një forcë e ashpër, e cila lufton kundër këtij pozicioni. Kujdes nga kjo energji e fuqishme që është e përqendruar dhe e guximshme.

### GAFORJA

Gjërat mund të jenë të vështira dhe agresive sot, por kjo nuk do të thotë që nuk mund të përparosh veçanërisht në aspektin financiar. Ekziston një energji që nxit njerëzit të veprojnë. Mund të mësoni disa mësimë të vlefshme duke dëgjuar të tjerët.

### LUANI

Sigurohuni që betejën që nisni ta fitoni ju. Ka shumë tension në ajër që mund të shpërthojë kur ju e prisni më pak. Mendoni me qetësi duke mos i marrë gjërat shumë seriozisht. Shpirti juaj i fortë i zgjidh të gjitha situatat.

### VRIGJERESHA

Mos u mundoni të luftoni njerëzit që janë aq kokëfortë sa refuzojnë të shohin një perspektivë tjetër. Në të njëjtin kohë, sigurohuni që të qëndroni të hapur për pikëpamjet e të tjerëve. Në dashuri tregohuni tolerant.

### PESHORJA

Sot do të mund të ndjeni një lidhje të fortë me anën tuaj imagjinare dhe romantike. Kini kujdes, sepse mund të zbuloni se një forcë e fortë agresive i kundërvihet këtyre ëndrrave. Shmangni personat negativë që ju rrethojnë.

### AKREPI

Edhe pse mund të mos pajtoheni me gjithçka që ndodh rreth jush, njerëzit kanë arsytet e tyre për mënyrën e veprimit. Mos u tregoni agresiv me ata të cilët mendojnë ndryshe nga ju.

### SHIGJETARI

Disa vendime që i keni marrë mund të mos miratohen. Kjo nuk do të thotë se ju duhet të hiqni dorë, përkundrazi, vazhdoni me të njëjtin ritëm. Nuk do të zhgënjeheni me rezultatit.

### BRICJAPI

Nëse e gjeni veten në një rënie sot, mos u shqetësoni. Shumë shpejt gjërat do të shkojnë mirë për ju veçanërisht në ekonomi. Parashikohet një rritje page ose promovim në detyrë.

### UJORI

Përdorni energjinë e zjarrtë të ditës për të përfunduar disa detyra të lëna pas dore. Në dashuri jetë ju favorizojnë, por ndërkohë duhet të tregoheni më aktiv. Daljet me miqtë këshillohen për ju.

### PESHQIT

Ke një prirje për të qenë agresiv. Duket sikur të doni të shpallni luftë me të gjithë. Përdoreni ditën për të aleancat dhe jo armiqtë. Thoni fjalët të ëmbla edhe ndaj njerëzve që nuk janë treguar pozitivë ndaj jush.

Interin e pret një ndeshje e vështirë në transfertë këtë fundjavë për Ligën e Kampionëve, ku përballë do të jetë Totenemi. Në prag të këtij takimi që mund të përcaktojë edhe fatet sa i përket kualifikimit për në turin tjetër, ish-trajneri i Kombëtares, Xhani De Biazit ka treguar mënyrën se si zikaltrit mund t'ia dalin. Në një intervistë për "Rai Due", tekniku



### De Biazit: Ndeshje e vështirë, Interi të besojë më shumë në cilësitë individuale

shprehet: "Interi duhet të besojë shumë në cilësitë individuale të futbollistëve, sidomos te Politiano, Perisic dhe Ikardit, pasi kështu mund të vihet në vështirësi kundërshtarit. Për fat të keq, Interi luan me një ekip që është në gjendje të mirë. Totenhem fitoi kundër Çelsit 3-1

dhe në fushë shihet një dominim i dukshëm. Interi nuk duhet të vuajë në këtë ndeshje, por të qarkullojë topin dhe të sulmojë në hapësirat që mund të krijohen. Këtu është nevoja për aftësitë teknike të këtyre lojtarëve Politianos Perisicit. Aftësia e tyre për të luajtur një kundër një,

krijimi i superioritetit numerik dhe shfrytëzimi i punës së Mauro Ikardit, i cili di të sulmojë hapësirat krijojnë mundësi shumë të mira për të shënuar. Por do të jetë një ndeshje e vështirë, sepse Totenhem është në gjendje të mirë këto kohë", u shpreh De Biazit

### MERKATO KUQEZI

#### Milani, goditje treshe në janar nga radhët e Çelsit

Milani po përgatitet të ndërhyjë në merkato dhe duke parë dëmtimet e shumta që po penalizojnë kuqezinjët në këtë sezon, është menduar që në janar të ketë disa afrime me të cilat mund të mbushen boshllëqet të paktën deri në fund të sezonit. Në listën e Leonardos janë disa emra, por objekti kryesor mbetet mesfushori spanjoll Çesk Fabregas për të cilin drejtuesit e Milanit përgatiten që të bëjnë një ofertë zjtare. Në verë, kontrata e tij me Çelsi përfundon dhe mesfushori nuk është i interesuar për të rinovuar. Në kushte të tilla, drejtuesit e Çelsit janë gati që ta shesin futbollistin në janar, për të përfutur të paktën një vlerë ekonomike. Gjithashtu, Kahill është një nga futbollistët për të cilët Milani ka interes dhe ashtu si Frabregasit, edhe këtij i mbaron kontrata në verë. Futbollisti i tretë për të cilin kuqezinjët mund të ofrojnë një huazim, është talenti Kristensen, të cilin Çelsi nuk e shet duke parë vlerat e tij dhe huazimi do ta ndihmonte.

Ngjarja e turpshme ndodh në Lacio-Milan, ultrasit bardhekaltër përkujtojnë terroristin grek



Në ndeshjen më të fortë të javës së 13-të të kampionatit italian, atë midis Lacios dhe Milanit ka ndodhur një situatë e papritur nga ana e tifozëve lacialë. Ata kanë hapur një banderolë me mbishkrimin e emrit të terrorisit grek Konstantinos Kacifas. Kjo banderolë shkaktoi shumë pakënaqësi, sidomos nga pala shqiptare, të cilët e quajtën një provokim të hapur këtë gjest, që është krenar dhe e pakuptueshme, për më tepër se ka ndodhur në një kampionat të nivelit të lartë siç është Seria A. Kujtojmë që pak javë më parë, Kacifas u kthye në shkak për një situatë jo të mirë nga ana politike midis Shqipërisë dhe Greqisë, teksa ekstremistët grek u ekzekutuan nga policia shqiptare, pasi hapi zjarr ndaj tyre. Tashmë kjo gjë po ndodh edhe në stadiume, pasi në stadiumin e kryeqytetit italian lejohet që të hapet një banderolë e tillë, ndoshta edhe racist. Kjo, pasi ngjarja e ndodhur nuk ka të bëjë fare me sfidën e zhvilluar

# Ultrasit e Lacios shpalosin banderolë pro-Kacifasit

Te Lacio është drejtor Tare dhe luan Strakosha



në kampionatin italian. Në mediat italiane e cilësuan si një provokim kundrejt dy shqiptarëve që janë

pjesë të skuadrës së Lacios, respektivisht Igl Tare (drejtori teknik i klubit) dhe Thmoas Strakosha

(portieri i parë i të kaltërve). Një gjë është e papranueshme, se si autoritetet italiane e lejojnë

që kjo banderolë jo vetëm të depërtojë në stadium, por edhe të shpaloset në sy të mijëra spektatorëve. Nga kjo foto dallohet qartë që tifozët që e kanë shpalosur këtë banderolë, janë tifozë grek që kanë qenë të pranishëm mbremjen e djeshme në stadiumin "Olimpiko" të qytetit të Romës, pasi përkrah banderolës së shpalosur, mbanin edhe flamurin grek. Ngjarja në fjalë vjen menjëherë pas zhurmës së madhe që krijoi shpalosja e një mesazhi kundër Kacifasit nga ana e tifozërisë së Partizanit, çka solli regjimin e kryeministrit Edi Rama, Presidentit Ilir Meta, Federatës Shqiptare të Futbollit dhe shumë personazheve të tjera, ndërsa prej më shumë sesa dy ditësh, kjo banderolë e dytë po kalon në heshtje.

### PËRBALLJA ME TIRANË

#### Partizani ngre çmimin e biletave për derbin

Krahas atmosferës së feshëve të nëntorit, në kryeqytet ndjehet edhe atmosfera e derbit mes Partizanit dhe Tiranës, që do të zhvillohet në stadiumin "Selman Stërmasi". Kështu klubi i kuq, në cilësinë e organizatorit të takimit, ka publikuar edhe çmimet e biletave për tribunën qendrore dhe ato të tjera, si për tifozërinë e kuqe, ashtu edhe për atë bardheblu. Drejtuesit e Partizanit kanë vendosur që një biletë në tribunat qendrore, konkretisht A1, A2, B1 dhe B2 të shitet në vlerën e 2000 lekëve të reja, ndërsa tribinat e tjera të shiten në vlerën e 500 lekëve të reja. Gjithashtu, janë ndarë edhe tribinat që do të jenë në dispozicion të tifozërisë mike dhe do të jenë pikërisht tribinat A1, A2, H1 dhe H2, ndërsa të tjerat do të jenë për tifozërinë e kuqe. Derbi i kryeqytetit do të zhvillohet ditën e premtë, në orën 18:00, ndërsa duhet thënë se çmimet janë relativisht më të shtrenjta sesa në ndeshjet e zakonshme apo edhe në derbin e organizuar më herët nga Tirana.

### Gjenezet themeluan si Bokën, ashtu edhe Riverin

#### Gjenova propozon: Copa Libertadores të luhet në "Luigi Ferraris"

Këtë të martë do të vendoset se kur do të luhet finalja e kthimit e Copa Libertadores mes River Plate dhe Boca Juniors e shtyrë në dy raste për shkak të sulmeve me sende të forta dhe gazlotsjellës nga tifozët e Riverit ndaj lojtarëve të Bocas, të cilët nuk ishin në gjendje për. Por përpara vendimit përfundimtar, dy klubet argjentinas kanë marrë një ftesë shumë interesante nga qyteti i Gjenovës në Ita-

li, që u ka bërë thirrje drejtuesit të dy klubeve për ta luajtur finalen e kthimit të Copa Libertadores në stadiumin "Luigi Ferraris". Që pas zyrtarizimit të shtyrjes, ka pasur shumë hipoteza se ku mund të luhet kjo ndeshje, pasi nuk përjashtohet mundësia që finalja e shumëpritur të zhvendoset në një vend tjetër larg Argjentinës. Rregullorja e parashikon se ndeshjet e shtyra mund të transferohen në ndonjë vend tjetër. Dje u mendua se mund të luhej në Abu


Dhabi, por ka një tjetër teori. Më shumë se teori është një kërkesë e bërë nga Bashkia e Gjenovës, që u ka bërë thirrje skuadrave që të shkojnë në të luajnë në Itali. Në kërkesën që është bërë për dy presidentët, të cilët janë me origjinë italiane, kërkohet që superklasikja më e famshme në botë të zhvillohet në stadiumin "Luigi Ferraris". Duket shumë e vështirë që të ndodhë, por në Itali duket se janë gati që të presin një nga përballjet më të zjarrta.

### Largohen Bogdani, Mustedanagiq dhe Memushi

#### Stuhia te Kombëtares e moshave, shpëton vetëm Bushi

Armand Duka duket se do të bëjë ndryshime në ekipet kombëtare të moshave, gjë që e ka pohuar vetë pak kohë më parë. Dhe duket se ka ardhur momenti që këto ndryshime të konkretizohen. Ndryshimet do të prekin të gjitha skuadrat e moshave, me përjashtim të Kombëtares U-21, që do të drejtohet nga trajneri Alban Bushi edhe në të ardhmen. Sipas "Procesi Sportiv", do të largohen Erjon Bogdani, trajneri i Kombëtares U-19. Vendi i tij do ta marrë Nevil Dede. Kurse ish-lojtar i Kombëtares, Elvin Beqiri, do të marrë drejtimin e Kombëtares U-17, e drejtuar deri tani nga Xhemal Mustedanagiq. Ky i fundit ka marrë detyrën e drejtorit të ekipeve kombëtare. Vlonjati Egrem Memushi do t'i lërë vendin Armand Damos në krye të Kombëtares U-15. Zyrtarizimi i trajnerëve të rinj të ekipeve kombëtare është parashikuar të bëhet sot nga FSHF-ja.

### Fjalëkryqi (1)



#### HORIZONTAL

- 1. Henri që qe piktor.
- 6. Janë si këshjtjella.
- 12. Maiden që këndojnë.
- 13. Janë enë benzine
- 14. Eshhtë melodramë.
- 17. Eshhtë vegël.
- 18. Gjysmë sterile.
- 20. Janë mallkime shkishëruese.
- 22. Ishte zogu simbol i Jezu Krishtit.
- 24. Ai dhe ajo.
- 27. Janë sëmndjet që përhapen.
- 29. Gjëja e romakëve.
- 30. Shenjtorja që iu pre koka.
- 31. Camus që shkroi I huaji.
- 34. Fillojnë ilustrimet.
- 36. Dieta pa ekstreme.
- 37. Ndërmarrje Autonome Sarandë.
- 40. Mund të jenë postare.
- 42. Ekstreme në sirtar.

- 43. I mungon asaj që i ka kaluar koha.
- 46. Një ekip... anglez.
- 47. Ente Ekonomike Rajonale.
- 48. Një Ilahatar.
- 51. Transporton edhe maune në det.
- 52. Quinn aktor.

#### VERTIKAL

- 1. Fillojnë mirë.
- 2. Nuk i tregohen babait.
- 3. Në hyrje të tokës.
- 4. Gruaja e dytë e Atamanit.
- 5. Merren në bllok
- 6. Kalimi në kufij
- 7. Qe burri i parë.
- 8. Frolich e Marlene Dietrich.
- 9. Kanë adeluar në parti.
- 10. Shteti pa shi.
- 11. Një pjesë e etiketës.
- 13. Një pellg.
- 15. Janë kundërshtarë në gjyq.
- 16. Eshhtë pije e jona.
- 18. Luhen me 1. X, 2
- 19. Mbretëria e Pirros.
- 21. Braktisi Didonën.
- 23. Emri tjetër i Esaut.
- 25. Një pjesë e territorit.
- 26. Një copë për xhepa.
- 28. Janë patriotë të Chopin.
- 32. Ray aktor.
- 33. Mund të jetë solemn
- 35. Alessandro, bomber te Juventus.
- 38. Ylli i Londrës
- 39. Sapo fillojnë
- 40. Emri i Mondrian.
- 41. Kufizojnë katete.
- 42. Lindi Isakun.
- 44. Thurman aktore.
- 45. Në mes të Tommy dhe Jones aktor
- 49. Harris aktor.
- 50. Një rajon kur s'është ajo.


### Fjalëkryqi (2)

#### HORIZONTAL

- 1. Gardnër që qe aktore.
- 4. Në krye të bashkisë .
- 6. Emër vajze.
- 9. Fillojnë pushimet.
- 10. Janë si biskota
- 14. Të fundit në ditar.
- 15. Janë trupa pa kënde.
- 16. Fillojnë notimin.
- 17. Në radhë të parë.
- 18. Pak latinisht.
- 20. Eshhtë gjendje të fikti.
- 23. Eshhtë vërtet e mërztitshme.
- 24. Një mund të jetë fetar
- 26. Gjysma e sallës.
- 27. Pak dorështrënguar.
- 28. Rastisin në krye.
- 29. Një... dollar.
- 30. Një pjesë e etiketës.
- 31. Skuadra e Moratti-t.
- 32. Ego... ime.

#### VERTIKAL

- 33. Eshhtë sport me stil të lirë.
- 35. Ekstreme ekstremi.
- 36. Një mbishkrim në kryq.
- 39. Kanë birë piktoreskë të tillë.
- 41. Një vendës autokton.
- 42. Argento aktore.
- 44. Një Behar, aktor komik.
- 46. Ka tre muaj.
- 48. Një fjalë si asnjëherë .
- 50. Në krye të armiqeve .
- 51. Janë legjenda.
- 52. Flet për të bukurën.
- 1. Një thirrje me emra.
- 2. Vulosen të parat
- 3. Këndojnë me zë të trashë të tillë
- 4. Një mund të jetë armë.
- 5. Mbyllin fushatat
- 6. Një grimcë me bërtamë.
- 7. Dacia shkriktare
- 8. Eshhtë lloj papagalli
- 10. Fillojnë afrimin
- 11. Kapet një me fishkëllimë.
- 12. Mbahet në mbledhje.
- 13. Ekberg aktore.
- 15. Janë zbuksime.
- 19. Janë diletantë
- 21. Janë zonat e kufizuara
- 22. Janë tallësit.
- 25. Fillojnë temën
- 26. Një gjë.
- 32. Bëhen për të mirë
- 34. Eshhtë shtet aziatik.
- 37. Inicialet e Nolte aktori.
- 38. Shkruhet në janar.
- 40. Teliti regjisor.
- 43. Një pjesë e dramës.
- 45. Rastet pa set.
- 46. Inicialet e Penn aktori.
- 47. Të fundit në studim.
- 49. Kufijtë e rritjes.



## Gjeni ndryshimin

Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra

Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

## SUDOKU

6	7			3		8
8	2		1	4	9	5
4		9				
			5	7		
	3		2		4	
1	9	5		8		2
			5			9
5	8		6		2	
4						

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

## Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	3	9	8	4	6	2	5	7
8	4	5	2	7	9	6	1	3
6	2	7	5	1	3	8	4	9
3	5	6	1	2	4	7	9	8
7	1	2	9	8	5	3	6	4
9	8	4	6	3	7	5	2	1
2	6	1	3	9	8	4	7	5
4	9	3	7	5	2	1	8	6
5	7	8	4	6	1	9	3	2

## Përgjigjet e fjalëkryqeve të numrit të kaluar

PËR GJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

S	E	V	E	N	U	P	S	T	E	F	F	I
A	M	I	N	K	A	P	I	T	A	L	I	
R	I	T	E	T	R	E	L			A	M	
A	L	E	T		F	I	L	O	K	T	E	T
H	E		K	A	M	I	K	A	Z	E	K	
			P	R	O	T	O	K	O	L	L	A
K	A	T	A	M	A	R	A	N		O	T	
I	R		C	O	L	I	N		R	O	M	Y
E	T	E	M	A		E	I		B	O	R	I
A	N	I	T	A		A	M	I	L	A	N	O
R	A	N		V	I	T	M	J	E	R	A	N
E	T	I	L	E	N		F	R	A	T	I	
B	A	O	B	A	B		P	E	D	A	N	A
R	P	E	R	I	P	A	T	E	T	I	K	E
A	P	E	L	R	I	V		B	N	A	R	
V	E	L	P	I	R	A	M	I	D	A	M	
A	R		K	O	L	O	R	I	T	I	L	E
P	R	O	T	A	G	O	N	I	S	T	E	T
K	A	N	I	T	A	T		K	A	T	E	
S	A		L	E	T	I		K	U	R	T	
P	I	R	E	S	I		P	I	R	A	T	I
I	R		M	I		B	A	N	O	R	E	T
K	R	A	T	E	R	E	T	G	J	I	R	I

FJALËKRYQI (1)

## Argëtim filozofik

-Një kokërr gruri nuk e mbush dot hambarin, por ndihmon kokrrat e tjera që e kanë mbushur.  
 -Ai që i përgjigjet me ligësi mirësisë sate, bëhet mjet për të bërë të njohur mirësinë tënde dhe ligësinë e vet.  
 -Forca e mendimit hynë punë më shumë se tehu i shtatës; prandaj ruaje atë dhe mbaje gati për ta përdorur në kohën e duhur.  
 -Shkalla e parë e marrëzisë është të kujtosh se je i mençur.  
 -Njeriu ka nevojë për arsim ashtu si bima për ujë. Ashtu sikundër që thahet pema kur është e njomë, po nuk u vadit, edhe njeriu thahet shpirtërisht po nuk u edukua qysh në fëmijëri (vogëli), sepse nuk i mbetet gjë për t'i shërbyer njerëzimit.

## KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

19	V	1	A	18	P	7	E	13	2		19	4	11	16	1		A	Z	O	V	E	T	N	A		B	A
1	6	1		15	7	9	12	2	12	2		11					Z	A	G	A	R	R	A	M	B	A	S
3	2		10	7	6	2	4	11	2	16						I	C	K	A	L	I	N	I	O	B	I	
7		12	4	11	7	6	13	7		3	3	18				L	C	A	S	U	S	B	E	L	L	I	
6	7	2		11	2	2		4		1	6	3				T	E	N	T	A	T	I	V	A	T	V	
18	18	1	6	1	11	1				1	3	4				M	A	R	T	I	N	A	E	N	K	E	
18			7			1	16	2	8	4	13	1				E	T	E	S	E	N	R	O	M	A	N	
6	1	5	3	7		11	7	13	2	6	4					T	I	M	E	T	I	P	I	A	F	E	
4	8	7		8	7		5	3	7		3	3				A	M	O	R	F	R	A	T	A	R		
19		15	2	7	13	1		7	13	3		4				L	O	N	Z	E	T	A	F	A	Z	A	
1	6	2	1	13	7	3		6		6	1	18				E	R	I	C	C	E	V	O	N	E		
3	7	6	6	2	3	4	6			11	7	3	2			T	E	A	M	A	L	B	A	N	E	T	

- Njeriu nuk është i përjetshëm, le të përpiqet të jetë e
- pavdekshme ajo që do të thotë dhe ajo që do të bëjë.
- -Gjërat që numërohen të shenjta, si mendja, njohuria dhe
- dituria, nga shkaku i lakmisë për famë e madhësi, s' mund t'u
- qëndrojnë disa dhërrave të kota, ndërsa dashuria mund çdo

- gjë. Dashuria duron varfërinë, nevojën,
- urinë, mundimin, poshtërimin, çdo gjë. Dashuria
- e ndryshon skëterën në parajsë. Njëqoftë se
- kërkohet një shenjë e botës shpirtërore në
- botën lëndore, ajo shenjë është dashuria.

## Thënie të mençura

